

FATOS KONGOLI
DRAGOI I FILDISHTË
R O M A N

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

DRAGOI I FILDISHTË

ROMAN

botimi i pestë

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Botimi i parë: 1999 (Shtëpia Botuese MÇM Çabej)
Botimi i dytë: 2005 (Shtëpia Botuese Toena)
Botimi i tretë: *dhjetor 2006* (Shtëpia Botuese Toena)
Botimi i katërt: *prill 2009* (Shtëpia Botuese Toena)
Botimi i pestë: 2018 (Shtëpia Botuese Toena)

Botues: Fatmir Toçi
Korrektore letrare: Jonida Kofina
Përkujdesja grafike: Mereme Nelaj
Kopertina: Irena Toçi

© Autori *dhe* Shtëpia Botuese Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "Muhamet Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++355 4 22 40 116; ++355 22 58 893

Tel./Fax: ++355 4 22 40 117

E-mail: toena@toena.com.al

redaksia@toena.com.al

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

1.

*A*i mbaroi kafen, mbaroi dhe konjakun, por i biri s'po dukej. Nuk ishte hera e parë që i ndodhte kështu. Ndodhte që djali të mos vinte fare në takim dhe burri nuk merakosej: një shtatëmbëdhjetëvjeçari mund t'i dalin motive nga më të ndryshmet, të mjaftueshme për të munguar në një takim pa kurrfarë urgjence, siç qe dhe takimi i tyre i zakonshëm të premtëve pasdite në orën gjashtë, gjithmonë në të njëjtin vend, në kioskën-klub të quajtur "Miqte e Afërditës". Këtu ata shiheshin sipas dëshirës së të birit. Ky kishte vendosur gjithmonë për kohën dhe vendin e takimeve, qysh kur e shoqja qe larguar nga shtëpia bashkë me fëmijët dhe divorci midis tyre ishte bërë fakt i

kryer. Atëherë vajza mbushte dhjetë vjeç, djali katër.

Në fillim ata i vinin të dy, vajza dhe djali. Takoheshin në një park lodrash me shilarës dhe karusel, vend i zgjedhur prej së shoqes për arsyen e thjeshtë se ndodhej pranë pallatit ku banonin prindërit e saj. Djali hipte mbi një luan, vajza mbi një patë. Mënjatë, midis grumbullit të të rriturve që ndiqnin dëfrimin e pjellave të tyre, ai lutej të kalonte koha sa më ngadalë; pas shpinës së tij, në një largësi të përshtatshme për të shmangur çdo të papritur, ishte e pranishme kurdoherë një gjë e gjatë, “rrezik vdekje” siç thuhet për qenie të tilla, fqinjë e prindërve të së shoqes, mikeshë femijërie e kësaj të fundit. Ngordhësira ia kishte shfaqur armiqtësinë qysh kur ai kishte filluar të hynte në shtëpinë e së shoqes, në fejesë, e mbase për këtë, për t’i ngacmuar nervat, ata ia dërgonin femijët me ngordhësirën. Sapo mbaronte koha e caktuar e takimit, me një lëvizje të dorës ajo u bënte shenjë femijëve. Vajza tregonte bindje shembullore, shkëputej prej tij dhe ua mbathte me vrap. Djali, përkundrazi, ishte problematik. Zinte e qante, ia lidhte krahët rreth qafës. Në këto çaste, i errur nga fodullëku i ngordhësirës, atij i hipte të shkonte ta shtronte në dru. Por tjetra së paku në këtë mes nuk i kishte ndonjë faj. Ajo vërtet i ngacmonte nervat, por ai nuk mund ta shtronte në dru vetëm pse i ngacmonte nervat.

Midis yshtjes për t'u ngritur dhe dëshirës për një tjetër konjak, burri ndezi një cigare. Të birit nuk i pëlqente kur vinte dhe e gjente me doza alkooli komprometuese. Mirëpo në rastet e vonesave të djalit ai e kishte të vështirë ta kalonte kohën vetëm duke pirë cigare. Në atë mjedis të rinjsh, ku shumica e vajzave pinin duhan ndërsa djemtë përzierjen “kaçurrel”, ndihej vjetërsirë. Kurrkush nuk ia varte, praninë e tij kurrkush nuk e vinte re, përveç ndoshta vajzave të shërbimit. Për t'i dëshmuar kotësinë e qenies së tij, ndonjë çift nuk e kishte për gjë të puthej aty, fare pranë tryezës ku rrinte në pritje. Në raste të tilla, si gjithë të pranishmit, bënte sikur nuk vinte re asgjë, pavarësisht nëse të tjerët shtireshin apo vërtet të puthurat në publik i linin indiferentë.

“Miq të Afërditës”, doemos, nuk ishte për të!... Atje mbledhej një klientelë në moshë të krahasueshme me të birin dhe ai nuk mund të mbetej aq indiferent ndaj fragmenteve femërore, fjala vjen gjinjve të lënë zbuluar me shkujdesjen më të pafajshme apo këmbëve provokuese. Dhe kur një ditë hyri në lodrën e syve me një vajzë, i poshtëruar nga vetja mendoi se ishte si ujku midis qengjave. Një ujk plak, mund të saktësonte i biri po të pikaste qoftë dhe një grimë të kësaj ane të natyrës së tij. Por djali ishte larg edhe dyshimit më të vogël.

Akrepat e orës shënonin gjashtë e dyzet e pesë. Sipas çdo gjase, i biri nuk do të vinte. Ai

gjeti shkakun për t'i lejuar vetes të porosiste konjakun e dytë, të cilin kamerierja, me fytyrë gati të shëmtuar, por me ca këmbë shumë të bukura, ia solli pa vonesë. Si mori prej zonjushës urimin “Të bëftë mirë, xhaxha!” me një theksim tallës të fjalës së fundit – sipas tij ajo e nuhaste që ia pëlqente trupin – burri zuri të pinte konjakun, i bindur përfundimisht se djali s’do të vinte. Nuk ndjeu keqardhje, as lëndim. Ishte gjëja më e natyrshme që djali të mungonte në takimin e tyre, kur në këtë mes ishte futur një element i ri. Ai nuk e konkurronte dot. Dhe as i shkonte nëpër mend ta konkurronte. I biri kishte një vajzë. Së paku prej dy muajsh.

Ujku plak, i/e ujkut plak, o ujkut plak, lakoi. Dhe e ktheu gotën me fund. Nga bokset shpërtheu me tone të larta optimizmi suksesi i ditës, kompleksi La Bouche me *Be My Baby*. Sytë i vajtën te një fotografi gjigante përballë tij, ku pozonte një çift. E veçanta e fotografisë nuk ishte përqaftimi i çiftit, as gjinjtë magjepsës të vajzës. E veçanta qenë pantallonat e saj të grisura, një palë xhinse ku pjesa e prapme mungonte dhe prapanica e manekines shfaqej madhështore. Ndoshta emërtimi “Miqtë e Afërditës” kishte lidhje pikërisht me këtë, me misteret e vajzës tek e cila nuk mund të përcaktoje se ç’pjesë të zbuluara të trupit të tërhiqnin ose provokonin më shumë. Atëherë e ngacmoi ideja për një tjetër konjak. Nuk porositi. Jo nga frika se mos kamerierja e vinte në

lojë duke theksuar fjalën tronditëse “xhaxha”. Në atë mjedis ajo ishte e vetmja që kuptonte diçka thelbësore nga punët e kësaj bote, dhe në njëfarë mënyre, ia bënte të ditur sa herë ia sillte rasti të hynin në marrëdhënie me ndërmjetësinë e gotave të konjakut. Por ai nuk porositi konjak tjetër ngaqë do të qe pa kuptim, siç qe e pakuptimtë enigma për trupin e vajzës së fotografisë. Pagoi dhe doli. Dhe la pas *Be My Baby*.

Ujku plak, i/e ujkut plak, o ujkut plak... Një vesë e hollë shiu e shkundi. Ai ngriti kokën nga qielli. Mendoj se pa atë shi rrezik të binte viktimë e mendimeve ogurzeza, fjala vjen se ishte qenia më e kotë në rruzull dhe nuk ia vlente të lëshonte hije mbi tokë. Në mot me shi, arsyetoi, s'bëhet fjalë për hije, ndërsa lagështira në zverk nuk të lë të filozofosh. Vrapo, ujk, jepu këmbëve! Është mëkat të biesh pre e mendimeve të liga.

Megjithatë ai vazhdoi të qëndronte përpara kioskës-klub me shpresë se mos nën dritën e fenerëve të makinave do të shquante të birin. Ky vinte me një biçikletë përdore dhe në krah të tij, prej rreth dy muajsh, ajo, vajza e hollë bionde. Te udhëkryqi ata ndaheshin për t'u takuar më pas s'dihej se ku. Ai nuk i binte në sy për mikeshën. Dhe as priste që i biri t'ia zinte me gojë. Mirëpo atë mbrëmje, një këmbëngulje absurde e mbante të gozhduar

në vend, derisa së fundi ra pre e mendimeve të liga: vetja iu duk i tradhtuar. I braktisur e i mohuar. Nga i vetmi njeri që i jepte kuptim ekzistencës së tij. Nga i biri... Për besë, edhe ai sonte do të bënte tradhtinë e madhe, do të shkonte drejt e te “Miqtë e Jupiterit”.

Nuk ekzistonte ndonjë klub me emër të tillë. Kështu ai quante një lokal të periferisë, pranë shtëpisë së tij, midis një grumbulli pallatesh, ku mblidhej një lukuni mashkullore e frikshme, ca tipa të zymtë me të cilët ishte punë e rrezikshme të ngatërroheshe. Pas nja tridhjetë minutash ecjeje nëpër shi ai mbërriti në vend dhe i shkrepri t’i propozonte pronarit të varte jashtë një tabelë me emërtimin tingëllues “Miqtë e Jupiterit”. Ky i përshtatej më së miri asaj qosheje. Atje, klientët e huaj, domethënë njerëz jo të zonës përreth, nuk guxonin të fusnin as majën e hundës. Lokali bëhej objekt i vizitave të policisë, sidomos netëve, kur klientët e zakonshëm, të ngarkuar me doza alkooli, zinin e shfaqnin një alergji agresive ndaj fytyrave të panjohura të ndodhura atje qorrazi. Po që se këto fytyra nuk tregonin vëmendjen e duhur ndaj sinjaleve paralajmëruese, për shembull thyerja e ndonjë gote, përplasja e karrigeve, sharjet me zë të lartë, çka do të thoshte se të padëshiruarit duhej të zhdukeshin, ato nxirreshin jashtë me njëfarë mirëkuptimi nëse nuk paraqisnin rezistencë. Në të kundërt, në rastin e rezis-

tencës më të druajtur, flakeshin përtej derës me dhunë. Pastaj, spektakli merrte ngjyra dramatike kur në lokal vinin qëllimisht në grup të paftuar sherrxhinj. Atëherë “Miqte e Jupiterit” kthehej në arenë përleshjesh.

Këto skena ai i ndiqte nga qoshja ku pinte. Ndihej i sigurt në paprekshmërinë absolute si klienti më i padëmshëm. Kurrkush nuk dinte ndonjë gjë për të veç faktit se ishte banor i pallatit aty pranë, në apartamentin e katit të katërt, një njeri i heshtur që nuk shoqërohej me askënd përveçse me gotat e konjakut, të cilat i boshatiste pa luajtur vendit derisa sytë i lëngëzoheshin, vështrimi i mjegullohej e jupiterasit diçka kuptonin nga e gjithë kjo dhe e pranonin në shoqërinë e tyre si relike të lokalit.

Nuk do ta ndërronte me asgjë tjetër këtë qoshe të netëve të lumtura. Ai nuk do të largohej prej andej po të mos ndodhte një vrasje. Mirëpo vrasja ndodhi dhe ai e pa skenën të gjithë. Pa sesi thika çau krahatorin e një djali e ai nuk mundi të bënte as lëvizjen më të vogël, edhe kur trupi i djalit u shemb i përgjakur, edhe kur atë e nxorën jashtë, e hipën në një veturë e vetura u largua me tërbim. Nuk lëvizi as kur klubi mbeti bosh dhe disa persona, civilë e policë bashkë, së fundi erdhën dhe e gjetën aty, me gotën e konjakut në dorë, me sytë e lëngëzuar dhe vështrimin të mjegullt. Ai nuk mundi të dëshmonte asgjë,

edhe pse përfaqësuesit e drejtësisë e thirrën një numër herësh pambarimisht sflitëse. Dhe ai përsëriti një numër herësh pambarimisht banale se nuk dinte ç'të thoshte, se mbante mend vetëm thikën që kishte çarë kraharorin e djalit, shembjen e tij përtokë dhe asgjë tjetër. Ndërsa të birit i pohoi: “Unë pashë gjithçka. Ata grindeshin çdo mbrëmje, hidhnin e prisnin batuta pa ndonjë kuptim për të pranishmit, por që fshihnin një kuptim për ta. Qenë kthyer nga Greqia me tufat e refugjatëve, të cilat greku e ka zakon t'i vërë përpara si bagëti sa herë i teket e t'i hedhë këndej. Ishin të krisur si të gjithë ata që s'kanë ç'humbasin përveç jetës. Njëri çau ferrën e dreqi e di nga fshihet në ndonjë ishull grek. Tjetri mbeti këtu, në palën e dheut. Ç'të dëshmoja? Krimi u krye për motive të dobëta, autori është larguar në drejtim të panjohur. Kështu shkruan gazetatat. Dhe gjithçka mbyllet si ajo përralla me fjalët “Natën e mirë fëmijë të dashur...”

Ujku plak, i/e ujkut plak, o ujkut plak... Burri u fut te “Miqte e Jupiterit”. Sikur në hyrje të lokalit të kishte marrë mundimin të hidhte një sy tutje, nga pallati ku banonte, do të vinte re se në katin e katërt, në apartamentin e tij, në dhomën-kuzhinë, në anën e këtejme, drita qe e ndezur. Kjo do të thoshte se aty ndodhej dikush. Por ai nuk e ktheu kokën. Ndihej i shpartalluar.

Rreth një orë më vonë, pas një numri gotash konjaku, njeriut që i hapi derën e apartamentit tek rrekej më kot në errësirë të gjente vrimën e çelësit, e kjo ishte një grua, i pohoi: Jam një derr i ndyrë, të harrova!

E mërzhitur nga pritja e gjatë, gruaja psherëtiu; më në fund ai kishte mbërritur, thoshte apo jo të vërtetën. Në raste të tilla ai gjithmonë sajonte diçka, gjente një shfajësim dhe të harruarit ishte shfajësimi më i pranueshëm. Kjo i ngjante pendimit të një fëmije, herë i urtë e herë mistrec, por gjithmonë i ëmbël në marrëzitë e tij. Ajo e kishte pëlqyer pikërisht pse ishte i tillë, ndryshe nga burrat e tjerë që kishte pasur mundësi të njihte intimisht në jetë, meshkuj të poshtër, njëri më maskara se tjetri, mosmirënjohës e mashtrues, përfshirë këtu edhe bashkëshortin zyrtar, me të cilin qe ndarë prej kohësh. Pa u merakosur nëse me atë “harrova” ai e gënjente apo i pohonte të vërtetën, ajo mbylli derën nga brenda me shul, njërin krah të tij e kaloi rreth qafe dhe, duke e zënë për beli, ia doli ta shoqëronte deri në kuzhinë, ku ai u shtri sa gjatë-gjerë në kanape, goditi ballin me pëllëmbë dhe përsëriti: Jam një derr i ndyrë!

Ajo e qetësoi me një të puthur, çka pati efektin e pritur. Ai u ngrit ndenjmur, kërkoi konjak, dëshirë që gruaja ia plotësoi, nuk kishte kuptim të mos ia plotësonte, përndryshe gjendja e tij do të keqësohej: Do të binte pre

e depresionit, do të niste të shante vetveten, ndodhte dhe të përlojej, e në këtë gjendje ajo nuk e duronte dot, qoftë pse i vinte keq, qoftë pse e çmonte dhe nuk mund t'i përtypete epitetet qesharake ndaj vetes. Burri për një çast u ndie në formë aq sa ta zinte gruan për krahu, ta ulte pranë, t'i jepte edhe ai një të puthur me synim të shkonin në dhomën e gjumit, të bënë dashuri e, si të bënë dashuri, t'i tregonte hallin e madh: tradhtinë e të birit. Punët rodhën pak më ndryshe. Ata vërtet u ngritën e shkuan në dhomën e gjumit dhe ai vërtet u ngacmua nga një vrundull dëshire. Por vetëm kaq. Ajo zuri ta zhvishte duke ia nisur me këpucët, çorapet, pantallonat, pastaj e ndihmoi të vishte një palë pizhama dhe në fund, kur mbështeti kokën mbi jastëk, i tundi para fytyrës një zarf. Të ka ardhur letër, i tha, nuk merret vesh nga kush. Vulat tregojnë se vjen nga Franca.

Në një orvatje të kotë për ta tërhequr gruan në shtrat, ai sajoi një buzëqeshje. Një përhumbe e thellë e kapiti, ndjesia e fundit ishte aroma e njohur e trupit të saj e në vesh i mbeti kumbimi i fjalës “Francë”.

2.

Nuk mund ta përfytyroja grackën e asaj dite, ishte jashtë çdo logjike. Do të besoja më lehtë se universi qe tkurrur, se bota qe kthyer në top ping-pongu. Diçka vërtet më shëmbëllente me topin e ping-pongut në ato çaste: kokërdhokët e bashkëbisedueses sime pas xhamave të syzeve optike. Por ajo nuk ishte Sui Lini, s'kishte as ngjashmërinë më të largët me Sui Linin. Dhe unë nuk ndodhesha në Pekin. Ndodhesha në Paris, ndërsa tjetra ishte një gazetare rumune. Këtë truri im e ngatërronte keq. Ka të ngjarë, për shkak të shëmbëllimit të syve të gruas me topin e ping-pongut. E topi i ping-pongut më sillte në mend Kinën. Nuk i shpëtoja frikës se ky obsesion kinez e bashkë me të kujtimi i Sui Linit më përgatisnin

një grackë. Po çfarë gracke gatuante për mua ajo e martë në Paris?

Shiu i butë në rrugën përpara hotelit s'mund të quhej ters. Këtë po përpiquej të më shpjegonte bashkëbiseduesja ime, me të cilën isha njohur vetëm një natë më parë. Quhej Patricia, punonte në një gazetë të kryeqytetit rumun, qe e divorcuar dhe përbuzte politikanët. Siç tha, vinte në Paris për të pestën herë, kishte njohuri për të gjitha stinët atje dhe ky lloj shiu i fillimit të muajit nëntor, aq paqësor e i pafajshëm – kështu u shpreh ajo gati me përkëdheli, paqësor e i pafajshëm – do të pushonte shpejt e ne, siç e kishim lënë, do të shkonim të bënim një fotografi në këmbët e Harkut të Triumfit. Desha t'i thoja Patricias se në vendin tim këtë e quanin “shi që lag budallenjtë”. Nuk ia thashë ja nga frika e një keqkuptimi, ja ngase aty për aty më lindi një ide tjetër. Ta pyesja në e kishin dhe rumunët një shprehje të tillë, pastaj nëse e gjeje te popujt e tjerë ballkanikë. Por edhe këtë ide e hodha poshtë. Mjaftojnë fjalët Ballkan dhe ballkanas që të më ngrihen nervat e trupin të ma përshkojnë rrëqethje, ishte ankuar një natë më parë Patricia gjatë një darke shtruar nga mikpritësit francezë për ne, domethënë një grup prej nja njëzet gazetarësh nga vise ballkanike. Unë nuk pranoja t'ia ngrija nervat Patricias, as t'ia përshkonin trupin të rrëqethura. Ajo ishte shpëtimi im, pa të do të më mbyste vetmia.

Ndjenja e vetmisë më kishte sulmuar ende pa u nisur, në sallën e pritjes së aeroportit të Rinasit. Dy kolegët e tjerë, shokë të udhëtimit, gazetarë të rinj, në atë moshë kur gjithçka e sheh nën këmbët e tua, më lanë të kuptoja se ata kishin ide të qarta parisiane dhe s'do të dëshironin t'i ndanin me mua. Synimi i tyre për të më shmangur nuk më befasoi. U përkisnin dy gazetave të kryeqytetit që shpalleshin të pavarura e unë, si shumicën e fletushkave, nuk i lexoja. Për paradoks! Edhe unë, njëlloj si ata, punoja në një gazetë, gjithashtu shpallur e pavarur, e ndoshta pikërisht ngaqë ndihesha i vetëmjaftueshëm nuk e quaja me vend, as të nevojshme, të merrja vesh se çfarë shkruanin gazetat e tjera. Pra nuk kisha ndonjë ide rreth varësisë apo pavarësisë së tyre, aq më pak të kolegëve të udhëtimit. Dhe s'më bëri ndonjë përshtypje kur ata, në sallën e Rinasit, u hoqën mënjanë, porositën kafe dhe paguan me dollarë, ndërsa mua s'më mbetej tjetër veç t'i admiroja që ishin aq të rinj e aq me përvojë. Pastaj vendi im në avion rastisi larg tyre, ata u ulën diku nga kreu, unë në bisht, atje ku lejohet duhani, megjithëse nuk e kisha kërkuar diçka të tillë. Kjo mjaftoi të më shkaktonte një gjendje vetmie nervoze, prej së cilës nuk shpëtova gjatë gjithë fluturimit e që mbërriti kulmin në aeroportin "Charles de Gaulle". Isha pajisur me një pasaportë të thjeshtë, të kuqe. Në pikën e kalimit të ekstrakomunitarëve

oficeri francez, me të ndeshur këtë ngjyrë, apo ndoshta identitetin tim, mori pozicionin e një demi të egërsuar. Me gjithë vizën e rregullt, më drejtoi gjithfarë pyetjesh, derisa më kërkoi nëse zotëroja ndonjë dokument ku të dëshmohej se në Francë dikush më kishte ftuar. Fatmirësisht kisha me vete faksin e ftesës. Ia dhashë e, si e shqyrtoi dhe këtë me shumë vëmendje, ma ktheu e më lejoi të kaloja, kësaj radhe me një buzëqeshje mirëkuptimi. Por kjo tashmë që e pamjaftueshme për të ndrequr humorin tim të zi.

Ky udhëtim në Paris kishte qenë për mua një dhuratë rënë nga qielli. Qyshse drejtori i gazetës më komunikoi vendimin e tij që në bazë të një ftese unë të përfaqësoja fletushkën tonë në një tubim gazetarësh ballkanikë në Paris, i humba të gjitha shprehitë e jetës. Lashë duhanin, ndërpreva pijen, iu largova lokaleve, hoqa dorë nga bredhjet natën, zura të rrëmoj në bibliotekën time e me këtë rast vura re sasinë tmerruese të pluhurit dhe merimangave që mbështillnin librat. Kjo nisi kur u njoftova zyrtarisht, rreth tre muaj përpara datës së caktuar të takimit, kohë e mjaftueshme për t'u idiotizuar deri në rrënjët e flokëve nga ideja e zbulimit të mrekullisë qiellore. Sepse Parisi kishte qenë për mua mrekullia qiellore e ëndërruar përjetësisht. Me një frenezi nga e cila u habita dhe vetë, në këta tre muaj lexova e rilexova të gjitha librat në frëngjisht

të bibliotekës sime, u përpoqa të rigjallëroj gjuhën e folur, kërkova andej-këtej revista në frëngjisht, me një fjalë bota u reduktua për mua në Francë. Jetova, siç thuhet, për tre muaj në ekstazë.

Atëherë m'u shfaq në ëndërr Sui Lini. Kisha një çerek shekulli, ndoshta më shumë, pa e parë në ëndërr dhe shfaqja e saj qe e pakuptimtë. Udhëtimi im në Francë s'kishte kurrfarë lidhjeje me Kinën, asgjë nuk mund të përlligjte këtë rizgjim të beftë të Sui Linit, veshur në të bardha, në një ceremoni mortore, midis një vargu njerëzish me kandila të ndezur. I tundnin në ajër, u binin gongeve dhe më shihnin me përbuzje. U orvata të bindja korteun se s'kisha bërë ndonjë të keqe që të meritoja përbuzje, por ata s'më kthyen përgjigje, vazhduan rrugën më tej derisa humbën në errësirë, bashkë me ta Sui Lini, pa më shpjeguar ç'ishte ajo ceremoni, kë varrosnin e përse ngutej të largohej. Në mëngjes ëndrrën e mbaja mend me të gjitha hollësitë. Sui Lini ka vdekur, thashë me vete, dhe një gulç më zuri grykën.

Trishtimi i kësaj ëndrre të beftë më mbajti të mbërthyer për disa ditë, fytyra e Sui Linit s'më shqitej. Nuk m'u shqit as në fund, kur zura të ngjisja shkallët e avionit, me përshtypjen edhe më të pakuptimtë se shkoja për në Kinë e jo në Francë. Në mendje, në vend të shprehjeve në frëngjisht, më vinin shprehje të varrosura në kinezçe, më pluskonin kushedi nga ç'thellësi

të errëta të kujtesës, dhe harroja se kjo jetë është një varg vogëlsirash banale që po nuk iu ruajte ta bëjnë ekzistencën skëterrë. Mjaftoi braktisja e kolegëve të udhëtimit që unë të ndihesha i vetmuar, e më pas, në kreshendo, ta kapërceja pragun e Parisit me humorin më të zi. Parisi ishte aty, ndërsa unë nuk isha në gjendje t'i përgjigjesha buzëqeshjes së mikpritësve, dy vajza të reja, njëra zeshkane, tjetra kuqalashe, dhe një djalosh në rolin e shoferit të mikrobosit, ku na ftuan të hipnim të treve, mua dhe shokëve të udhëtimit, për të cilët vajzat treguan, siç m'u duk, interesim të posaçëm. Mbeta mënjanë duke dëgjuar frëngjishten e çalë të kolegëve të mi. Këta, me një afërsi shtangëse, nuk ngurruan t'i tërhiqnin zonjushat në bisedë pa e çarë kokën se si tingëllonte frëngjishtja e tyre, mjaft që flisnin e ato u përgjigjeshin, e unë, gjithsesi, nuk mund të mos i admiroja kësaj radhe për sigurinë me të cilën filluan ta luanin lojën parisiane si partnerë të denjë. Një përpjekje imja për të dalë nga topitja më rëndoi keq e më keq. Frëngjishtja ime nuk binte poshtë asaj të djemve, por unë formulova një frazë të mefshtë dhe e shqiptova me zë aq të pasigurt, sa orvatja për të marrë pjesë në bisedë kaloi pa u vënë re, kurrkush nuk më dëgjoi e unë u mbylla përfundimisht, u bëra trung. Kështu kaloi faza aq shumë e ëndërruar e kontaktit tim të parë me Parisin, derisa mbërritëm në hotel. Vajzat më lanë në dorë një zarf me emrin tim, bashkë

me zarfin çelësin e dhomës e bashkë me çelësin porosinë që pas një pushimi të shkurtër prej një ore të ndodhesha me të tjerët në holl, nga do të niseshim për diku, në një lokal, ku do të shtrohej darka e mirëseardhjes.

Patrician e njoha atë mbrëmje. Në fillim e ndesha në ashensor. Portreti i saj m'u ngulit, sepse në kabinë nuk ndodhej kurrkush tjetër veç ne të dyve, dhe me gjithë mpirjen time të pabesueshme nuk mund të mos vija re kokërdhokët e syve të saj.

E ndesha prapë rreth gjysmë ore më vonë, si u ndamë në ashensor, në katin e katërt, ku dera u hap e ajo doli duke marrë me vete dritësimin xixëllues të syve, ndërsa unë vazhdova më tej, me zarfin në dorë dhe çelësin e dhomës nr. 813, drejt katit të tetë, si një provincial i trullosur, me një pakënaqësi të re ndaj kolegëve. Ata përsëri më kishin lënë vetëm, e përsëri fati u kishte buzëqeshur, përderisa nuk u duhej të ngjiteshin në katin e tetë, për t'u mbyllur në një dhomë numri i së cilës përfundonte me shifrën fatale për mua, 13.

Duket, për të vërtetuar këtë fatalitet, Sui Lini kishte vendosur të më qepej. Ajo m'u shfaq këtë herë në pasqyrën e dhomës, veshur në të bardha, siç më qe shfaqur në ëndërr. Iu luta të më linte të qetë, prania e saj këtu nuk më bënte mirë. Më çorodiste, më nxiste të shkrihesha në vaj. Pse duhej të më shfaqej pas

tridhjetë vjetësh me të bardhën e përzishme kineze, që e bënte të dukej edhe më e bukur pranë shëmbëllimit tim të neveritshëm në pasqyrë? Lërmë, i thashë dhe mendova përsëri se ndoshta ajo kishte vdekur. Ajo ngrihej nga varri për të ardhur tek unë. Po përse? Dhe përse pikërisht tani, në Paris?

Vajta në banjë dhe zura të provoja rubinetat, të ujit të ftohtë e të ngrohtë, dushin, i cili qëllon tepër i ndjeshëm dhe më lëshoi një curril të fortë drejt e në gjoks. Desha s'desha, bëra një dush, vështoj kostumin tjetër, u rregullova me nge që të kaloja në njëfarë mënyre pushimin prej një ore. Por koha zvarritej mizorisht ngadalë. Pas gjithë këtyre mbeteshin ende tridhjetë minuta të gjata e unë s'dija si t'i shtyja, ndonëse ndodhesha në mes të Parisit. Më përfshi një pesimizëm asgjësues, sidomos kur u binda se Sui Lini kishte vendosur të mos më shqitej. Fanitje të tilla nuk paralajmëronin asgjë të mirë për mua.

Atëherë sytë më zunë zarfin me emrin tim. Brenda gjendeshin tri kartëmonedha pesëqindfrangëshe. Shuma nuk më bëri ndonjë përshtypje, nuk e kisha idenë se ç'përfaqësonte ajo për ditët e qëndrimit tim në Paris. Më ngazëlleu mendimi se, sidoqoftë, një shumë e tillë do të mjaftonte të provoja disa gota "Martell" ose "Courvoisier", marka të ëndërruara konjakësh, ndeshur në leximet e mia, apo kalvadosin e personazheve të

Remarque-ut. I tunduar nga ky mendim, e mblodha të shkoja së pari në kafe-barin e hollit.

Para se të dilja e pashë të arsyeshme të ktheja një dozë me karburant vendi. Nxora nga valixhja njërën nga pesë shishet me konjak “Skënderbeu”, rezerva e sigurt e udhëtimit, mbusha një gotë masive me fund të trashë, i vetmi send që përdora nga inventari i frigoriferit. E ktheva me një frymë dhe qëndrova për të ndjerë efektin. Ky nuk mungoi të më ngrihej përbrenda në formë ngrohtësie. Dola duke lënë prapa, të mbyllur në dhomë, Sui Linin.

Një vrundull energjie më bëri të shpresoja se me pak përpjekje do të çlirohesha nga vështrimi brejtës i saj dhe shtypja e kotësisë së qenies sime aksidentale në kryeqytetin e botës. Vendosa t’i bindesha instinktit të vjetër, shpëtimtarit tim në gjendjet kritike: vajta drejt e në banakun e kafe-barit. Holli nuk ishte i madh, por një pasqyrë e vendosur në tërë faqen e murit përballë recepsionit krijonte iluzionin e hapësirës. Djaloshi i banakut më pyeti ç’dëshiroja dhe unë iu përgjigja me një frëngjishte që më doli vetvetiu se do të doja një “Martell” ose “Courvoisier”, e djaloshi m’u përgjigj se i vinte keq, atë çast nuk ia plotësonte dot këtë dëshirë zotërisë. Në vend të tyre më ofronte një uiski “Johnnie Walker”. Rashë dakord për një “Johnnie Walker”. E ktheva me dy gllënjka të mëdha e, meqë efekti që i mrekullueshëm, kërkova një tjetër uiski.

Djaloshi ma mbushi aty për aty. Atëherë në fronin e lartë pranë meje u ul gruaja e ashensorit. Edhe ajo porositi uiski.

Nuk mund të them si ndodhi që hymë në bisedë, i fola unë i pari gruas, apo u bë ajo kureshtare për mua. Kur Patricia zuri vend në fronin e lartë pranë meje dhe kërkoi uiski, vura re se qe ndërruar, qe veshur ndryshe nga ç'e kisha parë në ashensor dhe, si pretekst për ta tërhequr në bisedë, më lindi ideja ta pyesja nëse edhe asaj dushi i banjës i kishte lëshuar ndonjë fluks turinjve. Meqë një pretekst i tillë nuk m'u duk gjetje e zgjuar, s'hapa kurrfarë bisede për dushet, por jam i sigurt se u morëm vesh shpejt se ndodheshim në Paris për të njëjtin motiv e ky fakt, në njëfarë mënyre, na afroi, po të mos përmend uiskin me ndikimet e tij pozitive. Patricia madje dëshmoi sens të lartë mirëkuptimi ndaj meje, aq të lartë, sa pranoi t'i ofroja një uiski të dytë në pritje të kalonin minutat e mbetura deri në orën tetë e tridhjetë, kur i gjithë grupi duhej të mblidhej në holl për t'u nisur drejt lokalit të darkës ceremoniale.

Ne kemi ardhur dy vetë, shpjegoi Patricia, unë dhe Radu, një miku im i vjetër. Me të mbërritur sot në mëngjes, Radu takoi një mikeshë bullgare, duket ishin marrë vesh në telefon, sepse ajo e priste në aeroport, e që atëherë nuk i kam parë më, mbeta vetëm, e të jesh vetëm në Paris është tepër e trishtueshme.

E kuptova gjendjen e saj. Desha të formuloja diçka kundër të quajturit Radu. Në vend të kësaj ktheva uiskin. Dhe sytë më shkuan te këmbët e saj të zbuluara nën fundin e shkurtër, që bëhej edhe më i shkurtër për shkak të pozicionit të uljes në fronin e lartë. Ishte vetëm një çast e unë i largova sytë nga këmbët e Patricias, do të turpërohesha nëse ajo do ta pikaste vështrimin tim. Patricia nuk pikasi gjë, brenda pak minutash ajo krijoi një afërsi të habitshme me mua dhe shfaqti interes kur i shpjegova se isha përfaqësues i një gazete të pavarur të kryeqytetit shqiptar. Gojët e liga thonë se ne jemi të pavarur aq sa ç'mund të kenë qenë bujkrobërit... Idem si te ne, i dashur koleg, qeshi Patricia, ngjajmë aq shumë sa të vjen të ulërish.

Unë kam qenë gjithmonë i vonuar në kapjen e batutave. Nuk e rroka nëntekstin e së qeshurës së Patricias, as kuptimin e shprehjes sipas së cilës ne ngjanim aq shumë sa asaj i vinte të ulërinte. Megjithatë, falë vesit tim të lindur, një mirësjellje që e përbuz me tërë forcën e shpirtit, por nuk e kam në dorë ta flak, qesha dhe unë kot më kot, duke i dhënë fund uiskit. Dhe, tek ktheja uiskin, sytë më zunë tutje zonjushat franceze me kolegët e mi të veshur shik. Afërsia e tyre tashmë shfaqej bindëse. Kjo nuk më habiti. Ne shqiptarët jemi të pakonkurrueshëm në krijimin e afërsive, siç e kisha krijuar në ato çaste në mënyrën

time edhe unë. I dhashë garsonit një rën nga kartëmonedhat pesëqindfrangëshe e, ndërsa ai po më kthente restin, Patricia zbriti nga froni e m'u lut t'i qëndroja pranë. Atëherë vura re se drejt nesh po vinte një çift, dhe s'pata nevojë që mikësja ime e uiskit të më shpjegonte se ai burrë zeshkan rreth të dyzetave, me flokët drizë paksa të thinjur, ishte Radu, ndërsa shoqëru- esja e tij, një trupmadhe leshverdhë, bullgarja e aeroportit. Vinin drejt e nga shtrati, kuptohej. Radu më përshëndeti pa prituri të prezanto- heshim. Ai më shpjegoi se ndihej i lehtësuar që kolegja e tij, me sa shihte, nuk e kishte kaluar kohën kot, dhe gëzohej që i jepej rasti të njihej me mua në hollin e këtij hoteli parisian, të denjë për ca konviktorë fshati. Por s'ke ç'i bën, saktësoi, në këtë mes nuk ka asgjë për t'u habitur, këtu të gjithë ne jemi ballkanas dhe, sidoqoftë, për mikpritësit francezë nuk vlejme më shumë se ca konviktorë fshati. Edhe ju, i dashur koleg, e keni vënë re se Perëndimi, në njëfarë mënyre, po tallet me ne.

Nuk reagoja. Personalisht nuk shihja ndonjë arsye për t'u fyer nëse mikpritësit fran- cezë na vlerësonin deri në rangun e konvik- torëve të fshatit. Zoti Radu do të më jepte kënaqësi po që se bashkë me atë leshverdhën bullgare do të pranonte prej meje një uiski, siç kishte pranuar bashkatdhetarja e tij. Në ato çaste nuk kisha dëshirë të vrisja mendjen me arsyetime aspak produktive, po të përdor një

shprehje që hasej dendur në shtypin shqiptar. Dhe më duket se kështu i thashë, vërejtja juaj në rrethanat e dhëna është kundërproduktive dhe jo në drejtimin e duhur. Radu ia shkrepì një të qeshure shpërthyesë. U përkuì drejt meje e më përshpëriti: Ne u treguam nxënës të zellshëm të Perëndimit, bëmë siç na këshilloi. Ndërsa Perëndimi perden tonë të hekurt e ka zëvendësuar me një perde të hollë, të padepërtueshme. Më tmerron ideja se për ta nuk do të ngrihemì kurrë përmbi nivelin e konviktorëve të fshatit dhe se Perëndimi do të mbetet gjithmonë i mbyllur për ne.

Megjithatë Lindjen e ke të hapur, desha t'i thoja, duke parë sytë e vagëlluar të bullgares, dhe ndjeva të më ngriheshin nervat. Truri im prirej t'i thjeshtëzonte gjërat deri në vulgarizim. Ndërsa Radu u orvat edhe një herë të më shtje-llonte teorinë e tij, unë mendova se ai duhej ta kishte pasur të vështirë me bullgaren e mbase për këtë filozofonte e më gërricte nervat. Fatmirësisht kisha thithur aq doza alkooli sa të mos merrja asgjë seriozisht, as Radun, as bullgaren, as shokët e mi të udhëtimit atje tutje, që në marrëdhënie me zonjushat franceze dëshmonin së paku se në pikëpamje shqiptaro-ballkanase teoria e perdes perëndimore nuk i qëndronte dhe aq realitetit. Ky m'u duk argumenti më i fortë për të kundërshtuar Radun, dhe për pak do ta kisha bërë, sikur atë çast të mos ftoheshim t'u hipnim mikrobusëve;

Radu u largua pa e parë të nevojshme të përshëndetëj e unë ndjeva dorën e Patricias të më zinte për krahu.

Kur Patricia më zuri për krahu, Sui Lini ia behu pranë meje. Me mollëza të skuqura e sy të fikur, me një fjongo të kaltër lidhur në anë të flokëve. Nuk mbaja mend t'i kishte lidhur ndonjëherë flokët në këtë mënyrë, aq më pak me fjongo të kaltër. Në mikrobus, pranë rumunes, ndjeva prekjen e butë të këmbës së saj. Por ndoshta këmba ime, në errësirë, në një prekje të pavullnetshme, kishte gjetur këmbën e rumunes. Mikrobusi çante përmes një lumi dritash e unë nuk e pata në dorë të mos përlotesha, ja nën efektin e pijes, ja nga një dhimbje në kraharor. Ishte absurde, një fatalitet në mes të Parisit. E unë përsëri pata ndjesinë e një prapësie, e një oguri të zi. Po cila ishte prapësia që përgjonte dhe niste drejt meje Sui Linin për të më torturuar?

Tani, ajo natë parisiane, më duket shpikje e fantazisë. Darka, fytyrat, si pamjet e një filmi me personazhe groteske, mjedisi i errët, llambat në formë qirinjsh të tavanit, qirinjtë e vërtetë mbi tryezat rrumbullake që shpërndanin aq dritë sa njerëzit shëmbëllenin me maska. Dhe mërmërimat në dekorin e një skene prej teatri absurd, ku Sui Lini endej veshur në të bardha, me fjongon e kaltër lidhur në anë të flokëve, thujse enkas për këtë ceremoni.

Ka të ngjarë që shprehjen sipas së cilës fjalët “Ballkan” dhe “ballkanas” mjaftonin për t’ia ngjethur mishin, Patricia të m’i ketë thënë nga fundi i darkës. Atëherë në sallë u ngrit një zhurmë, pati thyerje gotash, një kamerier doli me të shpejtë nga diku e po aq shpejt u largua. Unë e përcolla gjithçka me një buzëqeshje idioti. Edhe sikur ta kisha marrë vesh ndodhinë aty për aty e jo të nesërmen, pra që një gazetar serb kishte qëlluar me shishe në kokë një kolegun e tij kroat, unë përsëri do të bëja të njëjtën gjë, domethënë do të sajoja buzëqeshjen prej idioti. Kjo i përshtatej më së miri gjendjes sime në atë lokal, rrethuar nga fytyra të panjohura, ku variantet e gjuhëve sllave ngatërroheshin me frëngjishten e çalë të të pranishmëve jofrancezë.

Të nesërmen mezi u zgjova nga tringëllima e telefonit, pa kuptuar ku ndodhesha, derisa i rashë në të se zëri që artikulonte në anën tjetër të fillit mbiemrin tim në mënyrë disi të çuditshme, për shkak të zhvendosjes së theksit, ishte i një zonje rumune të divorcuar, së cilës aty për aty nuk ia kujtova dot emrin. Tek përpiquesha t’i kujtoja emrin, m’u sollën para sysh xhamat e trashë të syzeve të saj, këmbët dhe, turbull, fare turbull, çasti kur nuk e di se ku e sesi, më kishte hipur dëshira ta merrja në shtrat. Kam gjysmë ore që i bie telefonit, por ju paskeni gjumë të rëndë, e dua t’ju kujtoj se e kemi lënë të shkojmë për një fotografi në Harkun e Triumfit. As unë

s'jam ngritur ende, ju flas nga shtrati, pra ose ju pres ose më prisni poshtë, OK?

Instinktivisht formulova një OK! Në anën tjetër telefoni u mbyll. Një copë herë, pa e lëshuar receptorin, nën peshën e dyshimit të tmerrshëm, shtrydha trutë për të kujtuar nëse isha orvatur vërtet ta tërhiqja rumunen në shtrat. U qetësova disi që ajo më kishte telefonuar, çka dëshmonte së paku se nuk ndihej e lënduar prej meje. Për t'i shpëtuar brejtjes mbusha gotën me konjak, e ktheva, pastaj vajta në banjë, shkumova fytyrën, zura të rruhesha ngadalë e, tek kundroja veten neveritshëm, Sui Lini qëndroi përballë meje. Nuk ishte veshur më në të bardha, as fjongon e kaltër në anë të flokëve s'e mbante më. Qe mbështjellë në mjegull, por ndoshta sytë e mi nuk shquanin qartë. Sui Lin, i thashë, më lër të qetë. Nuk shihemi prej tridhjetë vjetësh dhe këmbëngulja jote më bën të shkalloj nga trutë. Ke mbetur ajo e dikurshmja, sikur koha për ty të ketë ngrirë. Ndërsa unë... O Zot, Sui Lin, të lutem, ç'kërkon nga unë?

Ti s'e mbajte fjalën, foli ajo më në fund. Më premtove se do të ktheheshe, por nuk u ktheve. Dhe unë ia hipa kalit fluturues në hapësirat e galaktikave. E mbeta siç kam qenë. Ti nuk erdhe tek unë, po vij unë te ti.

I ktheva shpinën pasqyrës. Po të vazhdoja të dëgjoja zërin e Sui Linit do të çmendesha. Futa kokën në ujin e ftohtë të çezmës, e

mbajta gjatë, derisa nuk e dëgjova më zërin dhe u përshkova nga një vrundull i dyshimtë optimizmi, ndoshta ngaqë më erdhi ndërmend emri i rumunes.

Patricia ishte ulur në një tryezë pranë xhamllëkut të faqes anësore të hotelit, nga ana e rrugës. Me të vënë re të qeshurën e saj u mbusha me frymë dhe nuk ngurrova të përkulesha, t'ia merrja dorën e t'ia fshikja me buzë. Shiu që kishte rënë gjatë gjithë pasdites së djeshme vazhdonte të binte qetësisht mbi rrugën matanë, ku kalonin vetura e më të rrallë ndonjë këmbësor.

Më pas dita ime e parë parisiane shkoi rrokullimthi. Nisi me përpjekjet e mia të mundimshme për të treguar interes ndaj rrëfimit të Patricias mbi zënkën midis serbit dhe kroatit. Ç'është e vërteta, nuk më bëri ndonjë përshtypje, siç nuk do të më bënte edhe sikur rumunia të më thoshte se ata ishin goditur me thika. Me një frëngjishte gjithnjë e më belbacuke orvatesha të merrja pjesë në kritikën ballkanike të Patricias, pa e kuptuar përse ajo kishte vendosur të shkonim në këmbë deri te Harku i Triumfit, të strukur nën çadër, si dy budallenj që lageshin vullnetarisht, ndonëse ende nuk kisha guxuar t'ia tregoja historinë e shiut të budallenjve. Tek ecnim pata përshtypjen se të mbrëmshmen, pas kthimit në hotel, në ashensor, i kisha pëshpëritur se atë natë do të kisha pasur dëshirë ta kalonim bashkë.

Ndërsa ajo më tregonte se skena kishte plasur për një urë. Ju e hodhët në erë, paskej klithur kroati, por ne do t'ju hedhim trutë në erë. Atëherë, kur qenka kështu, më parë po t'i hedh unë trutë në erë, qenkej zgërdhirë serbi e pa e zgjatur ia paskej thyer shishen e verës në kokë.

Dukej qartë, s'qe e thënë të shijoja qoftë një grimcë arome parisiane. Asgjë nuk ma lejonte këtë luks, as shiu, as grija e ditës së ftohtë, as indiferenca e plotë e mjedisit ku po shtyheshim si dy qenie aksidentale, unë dhe rumunia. Si lamë prapa hotelin, Patricia më tërhoqi në një rrugë të gjerë me lëvizje të dendur veturash, pastaj në një kryqëzim u hap një bulevard i madh e tutje, larg, u shfaq Harku i Triumfit.

Do të ishte e përbindshme të përfytyroja se atje, në këmbët e Harkut të Triumfit, priste të më shfaqej një hije e groposur në kujtesën time prej kohësh. Kur hasa fytyrën e tij, e në fytyrë të qeshurën e dikurshme tallëse, do të besoja më lehtë se globi qe tkurrur, qe kthyer në një top të vogël ping-pongu, me madhësi të krahasueshme me kokërdhokët e Patricias, e cila nja tri metra më tutje po përpiquej të më fokusonte në kuadratin e aparatit fotografik. Ai m'u shfaq si një makth i dalë befas nga thellësitë e qenies, prapa gruas së përkulur lehtë drejt meje. Rumunia shkrepri aparatin dhe pa e vënë re shtangien time më kërkoi të

ndërronim rolet. Zura vendin e saj, ajo pozicionin tim të mëparshëm, që lejonte marrjen e një fragmenti të Harkut. Atëherë pas krahëve dëgjova qartë një psherëtimë dhe pas psherëtimës qortimin “Kurrë s’ke pasur gusto për femrat”.

Shkrepa aparatin. Nuk mund të them sa zgjati lëkundja ime midis yshtjes për të kthyer kokën, për t’iu përgjigjur thirrjes së atij zëri të harruar dhe dyshimit se këtu, në mes të Parisit, në këmbët e Harkut të Triumfit, truri im prodhonte halucinacione. Dija raste kur bashkatdhetarë të mi, me të vënë këmbë për herë të parë në Paris, kishin pësuar trauma nervore. U drodha nga mendimi se mos truri im po çoroditej, ishte nën të njëjtat efekte të fatkeqëve provincialë bashkëkombas. Mirëpo unë e kisha parë atë, zërin ia kisha dëgjuar qartë. Unë nuk mund të pranoja se sytë dhe veshët, me gjithë dozat e larta të alkoolit të marrë një natë më parë, të mund të më mashtronin deri në këtë pikë. Dhe kur më në fund, me një sharje që m’u ngrit përbrenda vendosa të ktheja kokën, fjalët më mbetën në grykë. Qenia të cilën sapo e kisha parë e sapo më kishte folur qe zhdukur. Frynte erë, nga një cep i hapur i qiellit u derdh dritë. Zot, mërmërita duke vështruar Harkun e Triumfit. Pashë rumunen të vinte drejt meje. Dhe në veshë më kumboi zëri i Sui Linit: Ti nuk u ktheve, nuk e mbajte fjalën!

Mbeta si i goditur nga rrufeja, pa e përcaktuar dot nëse fytyra e shfaqur ishte shenjë e dërguar nga Sui Lini apo hija më kishte ngacmuar tërë kohën me djallëzi të zeza telepatike.

3.

Zarfin ia zunë sytë pak përpara se të dilte. Mbi të as emër, as adresë dërguesi. Pullat tregonin se qe nisur nga Franca. Një letër nga Franca ishte njëlloj si t'i vinte nga Hëna. Mirëpo emri i tij shkruhej qartë, po aq qartë, adresa. E mori dhe e futi në xhepin e brendshëm të xhaketës. Hë për hë e mundonte migrena. Pak orë më vonë, pas mbledhjes rutinë të mëngjesit me shefin, kur mbeti vetëm në zyrën e tij, ai u kujtua për zarfin.

“Do të brengosesha po qe se nga ana jote kjo letër do të merret si shenjë dobësie. Të paralajmëroj qysh në krye: vazhdoj të të përbuz, siç më ke përbuzur ti.

Sa kohë kemi pa u parë? Dhjetë? Pesëmbëdhjetë? Njëzet vjet? Jemi parë rrugëve të Tiranës, qosheve të ndonjë birrarie, në ndonjë vrimë ku ti pije atë fërnetin e zi. Më je shfaqur i përfshirë nga avujt e alkoolit, mjerueshëm. Edhe në gjendje të tilla të kam përbuzur. Jo për shkak të statusit tënd të konfirmuar prej karagjozi. Si çdo gjë tjetër jotja, edhe karagjozllëku yt, pikërisht si i tillë, më sfidonte. Me shkujdesjen skandaloze që vinte deri tek unë për të dëshmuar dështimin tim.

Kur kam filluar të të përbuz? Mbase që në barkun e nënës, rrobalarëse modeste në të vetmen lavanteri mizerabël të asaj kohe në kryeqytetin tonë të lavdishëm, ndërsa ti në barkun e sat ëme, pianiste që luante pjesë mediokre vodëvilesh për ushtarët italianë në hotel “Dajti”. E përfytyroj, do të mendosh se vazhdon të më brejë kompleksi i inferioritetit ndaj teje. Gabohesh! Dua vetëm të vë pak në lëvizje atë trurin tënd të lëngëzuar nga alkooli.

Mjerisht, si unë ashtu edhe ti, kemi lindur në vitin '43. Si unë, ashtu edhe ti, jemi fëmijë të frikës, brez i ngjizur nga tmerrri i zhdukjes, nga ankthi i vdekjes, sido që ime ëmë ishte një rrobalarëse modeste, ndërsa jotja pianiste fatkeqe kafenesh. Të dyja viktimat të epshit ekzistencial të etërve tanë, ndjesë paçin atje ku u prehen kockat. Në barazi të plotë, në të njëjtën thellësi të dheut, brenda të njëjtit tip arkivoli, me po atë lloj pllake mbi varr,

pavarësisht se im atë, si bojaxhi, tërë jetën leu mure, ndërsa yti dha leksione morali.

Nuk është ndonjë habi të bësh armiq e të urrehesh nga njerëz, të cilët nuk i ke parë kurrë. Unë s'hyj në këtë kategori kanibalësh, specie e përhapur midis popullatës sonë me shtueshmëri të lartë. Kësaj speciejë nuk ke si t'i ruhesh. Ajo të ha, të shfaros ngadalë, progresivisht, derisa fikesh pa e kuptuar kush ta ka bërë varrin. Këta mbeten të shkrirë me turmën. Unë nuk kam dashur të shkrihem me turmën. As ti. Megjithatë ajo na hëngri të dyve.

Si kam nisur të të përbuz? Lehtësohem tek e zbraz këtë vrer. Ishim në atë moshë kur zilia është mëkati më i pafajshëm, kur për herë të parë të jepet mundësia të ndjehesh zot i vetes e të përftohet diçka e ngjashme me vrullin e një qeni të lëshuar nga zinxhirët. Kështu më dukej mua, që e dija me gjithë kuptimin e fjalës ç'do të thotë të biesh për të fjetur pa ngrënë. Dikur këtë e fshihja. Tani s'më vjen turp ta pohoj, as që im atë vinte në shtëpi çdo mbrëmje i pirë dhe puna e parë e tij ishte të rrihte nënën. Histori të tilla ala Maksim Gorki ti i ke lexuar vetëm nëpër libra. Këtu qëndron përparësia ime ndaj teje. Këtë përparësi e ndjeva në thellësi të qenies në çastin kur të vështrova nga larg. Dhe thashë me vete: ja një pinjoll i përkëdhelur. Ky nuk është rrahur nga i ati, s'ka rënë ndonjëherë të flejë pa ngrënë.

Bëj tani një llogari të thjeshtë. Sapo ka hyrë viti 1994. Ngjarja, nëse mund ta quaj të tillë çastin kur zbulova se në këtë botë ekzistojë dhe ti, ka ndodhur më 1961. I bie të kenë kaluar plot tridhjetë e tre vjet, për saktësi diçka më pak. Jemi në fillim janari, atëherë ishte tetor. Po shkonim në Kinë... Të ngacmova, kështu? S'ka se si të mos ngacmohesh. Edhe tani, që vendosa të të shkruaj, shkak bëhet Kina. Do të vete atje. Përfytyro, në Pekin, pas tridhjetë vjetësh!

Por të kthehem te zbulimi im, te çasti kur mësova se në këtë botë ekzistojë dhe ti, zbulim i kryer në një aeroport të Moskës, ku qëndruam nja katër orë, në pritje për të rifilluar rrugën drejt Pekinit. Ishim një lukuni e tërë, djem dhe vajza, tetëmbëdhjetëvjeçarë, shumica të hutuar e të shushatur, ja nga të vjellat gjatë fluturimit Tiranë-Moskë me TU-104, krenaria e aviacionit civil lindor të asaj kohe, ja nga zbulimet e para të përtej mëmëdheut të shtrenjtë, të mbetur pas.

Po rrije pranë faqes prej xhami të sallës së pritjes, ku bashkëkombasit tanë qenë shpërndarë andej-këndeje, ca nëpër kolltukë, ca në biseda me ruset bukuroshe të aeroportit, duke folur me këmbë e me duar, në përpjekje për të nxjerrë në vitrinë njohuritë e tyre të gjuhës ruse. Unë ndodhesha në anën e kundërt, gjithashtu pranë xhamllëkut. E mora me mend, ashtu si unë pak më parë, po

vështroje mjegullën dhe një rrugë që humbiste tutje, ku treteshin dritat në të dy anët e saj. Tek qëndroje atje, t'u afrua një vajzë. Ti e merr me mend për kë e kam fjalën. Edhe nëse nuk të kujtohet, unë e mbaj mend me të gjitha hollësitë.

Atë ditë të udhëtimit tonë të parë në botë, unë kisha veshur një kostum prej stofi të trashë të kombinatit të tekstileve “Stalin”. Kur them “të trashë”, kjo fjalë i përshtatej më së miri paraqitjes sime. Atë lloj stofi ngjyrë gri e përdornin për xhaketa fshatarët, më mungonte vetëm një stemë në gjoks që të plotësoja portretin e një kooperativisti të sajuar si për ditë feste. Përkundrazi, këtë portret e plotësonte denjësisht valixhja ime prej druri ku kisha futur sendet mjerane me të cilat u nisa drejt botës. Në atë gjendje unë kisha të drejtë të ndihesha i poshtëruar kur syri më zinte me shumicë tipa aspak interesantë. Fatlumë, po. Kështu dhe ti me atë kostum të bukur blu, kravatë, këpucë çeke e një gabardinë të gjelbër në dorë. Tek rrije matanë me vështrimin nga fusha e mbështjellë në mjegull, unë mendova se njëfarë trishtimi në fytyrën tënde ishte pozë e kërkuar për t'u dukur i veçantë, imitim i personazheve të letërsisë klasike ruse, me të cilët ne qemë të dashuruar. Ky mendim më ngacmoi, ngase pak më parë kisha përfytyruar se mjafton të gjeja një dalje, të përshkoja mjegullën, dhe do të ndeshja diku personazhin

tim ideal të kësaj letërsie, Peçorinin. Mirëpo sidoqë ndodheshim në Rusi, dyert për të dalë atje qenë hermetikisht të mbyllura. Ne do të vazhdonim më tej, gjithnjë drejt Lindjes, thellë e më thellë, për në Kinë, e në vend që të dilja të takoja Peçorinin isha i shtrënguar të qëndroja aty, midis turmës, i lënë mënjanë për shkak të atij kostumi të llahtarshëm.

Trishtimi yt i shtirë më mërziu shpejt. Po aq shpejt interesimi im ndaj teje do të ishte shuar, sikur në ato çaste syri të mos më kishte zënë Nirvanën. Këtë skenë, me siguri, ti nuk e mban mend. Ajo u ul në një kolltuk aty pranë, ti i hodhe pardesynë në prehër dhe zure vend në anë të kolltukut, mbi supin e saj. Ajo të tha diçka, ndërsa ti shihje dyshtemenë. Unë mendova se kjo që një tjetër pozë e kërkuar tëndja, e ndieje, të gjithë ju vështrojnë. E mua m'u duk se ti kërkoje pikërisht këtë, që lukunia jonë të shquante midis saj më të veçantit, përderisa gëzonte afërsinë e më të bukurës.

Edhe një pohim të fundit. Kam dashur shpesh t'i rrëfehem dikujt. Megjithatë përbuzja ime ndaj teje mund të fashitet vetëm kur unë dhe ti të mos bëjmë më hije mbi tokë, tani më duket se s'mund të gjej person tjetër më të përshtatshëm se ti. Nuk më kanë munguar të njohurit që do të pranonin të bëheshin konfidentë të mi. Por sa herë jam orvatur të hedh një hap, kotësia e ekzistencës së tyre më ka zmbursur, ata s'do të kuptonin gjë. Me ty

puna qëndron ndryshe. Kur të hasa dy muaj më parë në mes të Parisit, te Harku i Triumfit, u tmerrova. Në ato çaste një femër me syze po të merrte në fotografi dhe ti pozoje si mjeran. Më erdhi keq. Nuk pashë vetëm fundin tënd. Pashë dhe fundin tim, kotësinë e një jete që na kishte lidhur dikur e tani na puqte për një çast për të na dëshmuar se sa mizorisht ishim shpërdoruar. Këtë fakt e dija prej kohësh. Shumë gjëra njeriu i di, ia thotë vetes, por nuk do ose i mungon guximi t'i pranojë. Kur të pashë te Harku i Triumfit ua mbatha, më mbërtheu një mërzi e zezë. Megjithatë këmbët më çonin çdo ditë te Harku i Triumfit. Në Paris gjen shqiptarë me duzina. Mua s'ma ka qejfi të takohem me ta, përveçse kur më merr malli të flas shqip. Është e vështirë ta shpjegoj përse atë ditë, sapo mbërrita në hyrjen më të afërt të metrosë, u ktheva mbrapsht, zura të ecja me nxitim, gati me vrap, me shpresë se do të të gjeja atje ku të kisha lënë. Por ti ishe zhdukur. Dhe unë s'dija ku të kërkoja...”

Një copë herë burri mbajti nëpër duar fletët e letrës, të mbushura me shkrim të imët. Leximin e kishte ndërprerë pa mundur ta çonte deri në fund. Ka dhe idiotësi të tilla, mendoi. I mblodhi fletët shuk, bëri një top, e flaku drejt koshit në cep të zyrës, mirëpo topi goditi faqen e shportës, u kthye mbrapsht dhe qëndroi në mes të dhomës. Atë çast, përmes derës së lënë

hapur, ai pa një siluetë femre në korridor. Truri i tij nuk e vendosi menjëherë nëse sytë duheshin përqendruar te topi apo mbi siluetën e femrës. I penduar që e kishte flakur letrën, ai mendoi se do të ishte e arsyeshme të ngrihej, ta merrte, ta shpaloste e ta çonte deri në fund. Por mbeti i gozhduar në karrige duke parë siluetën e femrës. Ajo humbi në kthesën e korridorit, ku vinte një tjetër korridor, në krye të të cilit shfaqej një derë e mbi derë fjala “Drejtori”. Me të mbërritur atje vizitorja, dera do të hapej. Ajo do të hynte brenda, do ta mbyllte derën nga pas duke rrotulluar çelësin në bravë, po mbase këtë veprim do ta kryente ai që e priste. Më tutje, se ç’ndodhte pas lëvizjes së çelësit në bravë, mund të merrej vetëm me mend. Thuhej se drejtori në raste të tilla ishte i paduruar. E rrëmbente partneren në krahë dhe e shtrinte mbi tryezën e punës.

Silueta që zhdukur dhe sytë e tij u kthyen te topi. Do të vinte bast se drejtori ndërkaq e kishte përmbysur partneren mbi tryezë. E kishte parë në mëngjes te klubi përballë zyrave të redaksisë tek pinte fërnjet me llokum, çka, sipas kolegëve, ishte shenja më e sigurt se atë ditë një seancë tridhjetë-dyzetminutëshe që e pashmangshme. Kjo dëshmonte se ai përgatitej të vinte në qejf dhe qejfin do ta çonte deri në fund me një nga partneret e tij të rregullta, të cilat, sipas një grafiku, i vinin për vizitë në ditë të caktuara të javës. Në bazë të vëzhgimeve

joqëllimkeqe të kolegëve, grafiku në fillimjavë i takonte një biondine rreth njëzet e pesë vjeç, shtatmesatare, me flokë të prera shkurt, e kolme, tipi i asaj femre që në zhargonin e vjetër cilësohej “kërtopçe”. Si rregull, dita e vizitës së Kërtopçes ishte e hëna. Në mesjavë, të mërkurë ose të enjte, dukej një zeshkane, po me flokë të shkurtra, veç më shtatlartë se Kërtopçja, e cila tashmë ndihej si e shtëpisë, aq sa përshëndetej miqësisht me çdo njeri në hyrje të redaksisë ose korridoreve, e mbase për këtë, për shkak të mirësjelljes së saj, midis tyre, në shenjë përkëdhelie, gazetarët e mbiquanin Motra. Së fundi, vinte partnerja e tretë, zeshkane dhe kjo, me flokë të lëshuar, me ca këmbë të bukura që nuk mungonte t’i vinte në dukje duke parapëlqyer të vishte minifunde. Kësaj grafiku i takonte të shtunave, dhe atë ditë ishte pikërisht e shtunë. Këmbëbukura e minifundeve dëshmonte një ndjeshmëri të lartë. Në disa raste, po t’i afroheshe derës së drejtorit, kur ai mbyllej brenda me të, mund të dëgjoje rënkimet e saj në formë klithmash pa qenë nevoja të mbështesje veshin te dera. Prandaj qe pranuar njëzëri kur dikush kishte propozuar, ta mbiquanin Qejflesha.

Burri u ngrit dhe vajti drejt topit në mes të dhomës. Ai mendoi se bota qe çmendur. Ai tha me vete se bota kishte qenë vazhdimisht gjithmonë e kurdoherë e çmendur. E dëshmonte dhe topi i letrës. Jeta e tij mund të përmbli-

dhej në përmasat e atij shuku letre të pavlerë, i denjë të hidhej në kosh. Po ndoshta, tha së fundi, unë vetë tashmë jam i flakur në kosh.

U përkul, mori topin dhe me duart që iu drodhën paksa shpalosi fletët. Prej vitesh nuk merrte letra. As shkruante. Ai nuk dëshironte të merrte letra, as të shkruante. Tani merrte letër nga një fantazmë. S'mund të qe tjetër veçse fantazmë, përderisa mbi zarf nuk kishte emër dërguesi, as adresë, përderisa letrën nuk e nënshkruante kurrkush. Me sa dukej tani po hynte në kontakt me fantazmat. Por fantazma e tij nuk ishte prodhim i një seance spiritizmi, as i trurit të çoroditur, siç kishte besuar në Paris. Fantazma e tij ekzistonte. Dhe dinte të shkruante. Dhe kishte një emër. Dhe kishte një adresë. Por nuk donte t'i jepte. Së fundi, pas një yshtjeje të re për t'i grisur e flakur fletët në kosh, burri ndërroi mendje, i palosi dhe i futi në xhepin e brendshëm të xhaketës.

Është ngritur nga varri të më çajë kokën me idiotësira, tha me vete dhe doli.

Të shtunat ishin ditët më të zbrazura për të. Pasoheshin nga të dielat, edhe më të zbrazura. Të shtunave pasdite dhe të dielave ai mbyllej në shtëpi me shishet e konjakut. Në një limonti banale. I brejtur nga një dilemë: të martohej apo të mos martohej sërish?

E dashura Rita, e shtrenjta ime Rita, zuri të recitonte heshturazi një deklaratë, të cilën e

kishte përsëritur aq shpesh me vete sa e dinte përmendsh dhe po të ulej mund ta shkruante lehtësisht. Nuk do ta shkruante. Rita do të shkrihej gazit. Dhe, më kryesorja, çka e bënte vazhdimisht të pavendosur, ishte frika prej adoleshenti nga një refuzim i saj. Kish mjaft të ngjarë që Rita ta hidhte poshtë kategorikisht një propozim të tij për martesë.

E dashura Rita, e shtrenjta ime Rita. Mbi të gjitha dua të mos më tallësh dhe të më besosh se i bluaj këto fjalë prej kohësh. Së paku këtë duhet ta mbash mend, domethënë ditën që u njohëm, dy vjet të shkuara kur unë u shtrova në klinikën e nefrologjisë nga një krizë veshkash e ti ndodheshe e shtruar po atje, në një pavijon, me meshkuj e femra bashkë. Ndodheshim, pra, të dy, atje ku bëhet remonti i qenieve njerëzore e, ndërsa unë e kisha të nevojshëm këtë remont para se të flakem në togun e hedhurinave, ti, siç m'u duk, gjendeshe përpara kohe. Atë ditë, në dhomën time, dha shpirt një nga të shtruarit. Mua s'më bëhej të kthehesha në dhomë. Qëndrova jashtë, në ballkonin e katit, dhe në mërzinë e zezë të vdekjes fytyra jote ishte ngushëllim për mua. Të kisha parë në televizor e në filma. Guximi për të hyrë në bisedë me ty nuk ka lidhje me tipin tim të pakontrolluar. Në ato çaste ti s'mund të ushtroje mbi mua kurrfarë tërheqjeje seksuale, sidoqë fustani yt i hollë, në shkujdesjen e spitalit, nxirrte në pah format

e trupit tënd, të shëndoshur ca, sigurisht, por joshës. Në vapën mbytëse të asaj dite, që bëhej më mbytëse nga trishtimi i vdekjes, kur të pashë ulur në fron, mendova se isha nisur drejt teje prej kohësh. Nëse deri atë ditë nuk ishim takuar, kjo që një lojë e rastësisë, e cila tani po na puqte në ballkonin e një spitali, tek më mbyste trishtimi ndërsa ti vështroje qytetin. Atë ditë edhe ti ishe e trishtuar dhe unë u hutova nga pohimi yt se nuk vleje një grosh si aktore, se teatri dhe filmat të kishin ardhur në majë të hundës e nuk doje të dëgjoje për to. Që nga ai çast i mbylla të dy kapitujt, edhe të teatrit edhe të kinemasë, për mua ishin fusha të ndaluara, nuk më lejoje të futesha. Por as unë nuk kisha ndonjë dëshirë të futesha, aq më pak të luaja teatër me ty, siç nuk doje ti të luaje teatër me mua. Dija vetëm një gjë: vrapoja drejt teje prej kohësh, qyshse u ndjeva i braktisur në këtë botë dhe gjithçka tëndja më ishte familjare, edhe fytyra edhe zëri edhe lëvizjet edhe frymëmarrja. Kjo më dha zemër të rrija pranë teje në ballkon duke vështruar qytetin derisa i yshtur nga një marrëzi guxova të të bëja komplimentin e trashë se emri yt, pra Rita, ishte emri më i bukur femëror. E kuptova në çast, këputa një gomarllëk. Nuk u habita kur ma ktheve me qortim, gati e pakënaqur, se nuk të dukej që emri yt të kishte ndonjë bukuri të veçantë. Më shpartalloi ajo çka shtove më pas. Zakonisht në libra këtë emër ua vinin

prostitutave, kështu the, kështu mendonin dhe regjisorët e tu, të gjitha prostitutat e romaneve dhe filmave quheshin Rita, por për ty nuk kishte rëndësi, përderisa nuk ushqeje ndonjë paragjykim ndaj prostitutave.

E dashura Rita, e shtrenjta ime Rita. Më duket sikur këto fjalë t'i kam thënë me qindra herë. Në të vërtetë s'kam guxuar të t'i them as në çastet më të bukura, kur jemi bashkë e unë nuk ndihem i braktisur, siç ndihem sapo ti largohesh e më lë vetëm, me fantazmat e mia. Ma ha mendja, edhe ti ke të tuat. Tek e fundit secili ka fantazmat e veta që e sulmojnë, e çukisin me sqepat e mprehtë gjer në gjakosje, si në ato filmat-makth të Hichcock-ut. Tani, shpendëve të makthit u nxjerr përpara mburojën "Rrofshin Ritat e botës".

Rrofshin Ritat e botës, hungëriu burri tek kapërcente rrugën për t'u hedhur në trotuarin tjetër. Atëherë sytë i zunë të birin. Mbeti në vend, si një hajdut i kapur me presh në dorë.

E kishte përjashtuar gjithmonë çdo mundësi bisede me të birin për atë që midis tyre mund të quhej "Çështja Rita". Ishte përpjekur, dhe ia kishte dalë, t'ia mbante rreptësisht të fshehtë "Çështjen Rita". E gjykonte tepër të njomë për ta tërhequr në subjekte të tilla dhe një mirëkuptim do të qe i pamundur: djali ndodhej nën pushtetin e së ëmës, e kjo nuk ishte martuar më. Në këto kushte, me të parë

të birin, thirrja “Rrofshin Ritat e botës” i mbeti në grykë.

Ai nuk e pati në dorë të mos binte pre e një kompleksi fajesh. Nuk e shpëtoi as zemërgjerësia e të birit, i cili sapo zunë vend në një tryezë të lokalit i ofroi alkool. Ishte e jashtëzakonshme që i biri t’i ofronte alkool. Një copë herë ata qëndruan përballë njëri-tjetrit në heshtje. Ai nuk e pa të nevojshme t’i kërkonte ndonjë sqarim për mungesën e së djeshmes, as djali nuk e pa të nevojshme t’i jepte ndonjë shpjegim. Kur kamerierja u solli porosinë dhe djali zuri të thithte lëngun e portokallit, vuri re se ai qe dobësuar.

Kishte dalë nga redaksia me një plan, dhe mbërritja e të birit po ia prishte. Ai llogariste të merrte në klub dozat e para të konjakut, pastaj të kthehej në shtëpi, të mbyllej e të bluante dilemën: të martohej apo të mos martohej prapë? Ndihej i hutuar, me një letër absurde në xhep, me dëshirën e papërmbajtur për një tjetër konjak, me enigmën e fytyrës së zbehtë të të birit.

“Mami kërkon të të takojë”, foli më në fund djali.

Sytë e burrit kishin mbetur mbi gotën e zbrazur.

“Kërkon të të takojë nesër, pasnesër, kur të duash ti”, shtoi djali.

Burri ngriu, pa mundur t’i hiqte sytë nga gota e zbrazur.

4.

Nuk më kujtohet koha që shënonin akrepat e orës. Më kujtohet data: 4 gusht 1964.

Në atë orë e në atë datë, kur rrotat e avionit Boeing të shoqërisë pakistaneze PIA prekën pistën e aeroportit të Rinasit, unë nuk e dija, dhe as e çoja nëpër mend, se s'do të kthehesha më në Kinë. Pas tre vjetësh largimi, në fund të fluturimit Pekin-Tiranë, me ndalesa në kryeqytete të Botës së Tretë, isha vetëm pjesërisht i ndërgjegjshëm për humnerën midis meje dhe asaj që ikte. Rugës më kishte lodhur shqetësimi se diçka kisha harruar, vrisja mendjen të gjeja çfarë dhe më dilte se jo, asgjë nuk kisha harruar. Megjithatë truri im përpihej nga mjegullnajat e reve tej dritares së avionit, në

një humbëtirë pa anë e fund. E përsëri vuaja nga ndjesia se diçka kisha harruar.

Atëherë midis reve më shfaqej një dragua. Ai dilte nga humbëtirat e reve e mua më dukej e pabesueshme. Dragoi madhështor, me luspa fildishi, orvatej mundimshëm të më jepte mesazhe. Unë s'kuptoja asgjë, shihja vetëm trupin e tij, praruar me të gjitha ngjyrat e ylberit, tek dukej e zhdukej nëpër re derisa më kaplonte një zhytje trullësëse në pavetëdije e më bëhej se ndodhesha ende në shtrat me Sui Linin. Në pritje që të zbardhte. Shpresoja të mos zbardhte kurrë. Të rrija përjetësisht kështu, pranë trupit të saj të ngrohtë.

Përshtypja e gënjeshtërt më acaronte. Ca më tepër euforia e bashkëstudentëve të mi në këtë kthim si nga syrgjyni. Unë nuk e dija nëse ata kishin lënë gjë prapa. Unë kisha lënë. E duhej të kthehesha patjetër. Sa më shpejt.

Babai që plakur. Nëna po ashtu. U përpoqa të buzëqesh, por më doli vetëm ngërdheshje. I lemerisur, bëra çmos të dukeshja i gëzuar. Ngrita rrëmbimthi në krahë vëllanë e vogël, të zgjatur nja dy pëllëmbë, e përqafova për të fshehur gulçin në grykë. Fatmirësisht ata s'vunë re gjë. Zbehjen e fytyrës sime e morën si shenjë malli. Nëna u përlot e unë u shkunda, më përfshiu një llafazanëri e shfrenuar, e kjo vazhdoi gjatë gjithë rrugës nga aeroporti në shtëpi.

Atje më priste një drekë e shtruar për një njëzet vetë, tepër e ngushtë, tha nëna më pas. Djali kthehej nga një vend i largët. Në arsenalin e mallkimeve popullore ai sendëzohej me shprehjen “Vafsh në Çinemaçin”. Mirëpo me gjithë largësinë e llahtarshme që më ndante tashmë nga dhoma ime e konviktit në Universitetin e Pekinit, mua nuk më dukej kështu. E vetmja dëshirë imja në ato çaste ishte të merrte fund sa më shpejt kjo ceremoni. Ndërsa të ftuarit, për nder tim, përballonin një torturë të vërtetë në dhomën ku qe shtruar dreka, në temperaturën mbytëse të fillingushtit. Dhe s’donin t’ia dinin për këtë, dhe as e vinin re se unë mezi po rrija, se ca nga ca po më vinte në majë të hundës nga pyetjet e tyre, derisa më kërkuan t’u demonstroja se si hahej me shkopinj të kinezë. Im atë e gjykoi të arsyeshme t’i jepte fund gostisë kur ajo rrezik të degradonte nga euforia dhe dikush, i ardhur në qejf, këmbënguli të formuloja në kineçze disa nga sharjet më të ndyra të gjuhës shqipe. Atëherë e pashë të mundshme të kërkoja leje të largohesha nga tryeza.

Në dhomën time s’kishte ndryshuar asgjë. I njëjti krevat, e njëjta mbulesë, e njëjta tryezë pune mbi të cilën gjendej radioja e vogël e prodhimit rus. Muret qenë lyer, ishin hequr të gjitha fotot e prera nga revistat, të ngjitura dikur mbi to, e ky qe i vetmi ndryshim, po të

mos përmend se sytë nuk më zunë gjëkundi Shushukun, maçokun e shtëpisë. Nuk u interesova të mësoja ç'ishte bërë as atë ditë, as më vonë.

Qetësia dëshmonte se të ftuarit ishin larguar. Ndihehin pëshpërime, kërcitje pjatash, dikush me zë të ulët i përgjigjej dikujt në telefon. Kujdesi i tyre për të mbajtur qetësi ishte pa vlerë. Me gjithë këputjen time s'mund të vija gjumë në sy. Më vinte shumë keq që pas rraskapitjes së udhëtimit s'më rrihej në shtëpi. Doja të ndodhesha diku, larg të njohurve. Prania e tyre më hiqte çdo mundësi për të arsyetuar. Më duhej me çdo kusht të qetësoja veten, të bindesha se çdo gjë rridhte normalisht. Pas dy muajsh do të kthehesha në Pekin, do t'i kapja punët aty ku i kisha lënë, duke i telefonuar së pari Sui Linit.

Këtu arsyetimi im këputej. Nuk gjeja asnjë motiv kundër kësaj logjike sendesh. Pra, do të kthehesha në Pekin, e shumta pas dy muajsh, dhe para çdo gjëje tjetër do t'i telefonoja Sui Linit. Në telefon s'do të flisja as rusisht, as frëngjisht. Do të përdorja kinezçen me këdo, qoftë ky i ati. Dhe nuk do ta kërkoja me emrin e saj rus, Raisa. Do ta kërkoja me emrin e vërtetë, Çao Sui Lin. Nuk do të dredhoja më, cilido zë të më dilte në telefon. S'do të fshiheja pas identitetesh të rremë. Do t'ua thoja troç, jam një student shqiptar i Universitetit të Pekinit. Ah, po, mund të më përgjigjej i ati,

jeni ai shqiptari që e mashtron Sui Linin me përralla dhe mban në tension frike familjen time. Më në fund dua t'ju vë në dukje se në mos i paturpshëm, jeni i pandërgjegjshëm. Edhe në rastin më të mirë për ju, po të besoj në singëritetin tuaj, përsëri kam të drejtë t'ju bëj fajtor. Duhet ta dini mirë se duke këmbëngulur të takoni Sui Linin nuk i sillni gjë tjetër veçse fatkeqësi. Prandaj, djalosh, mjaft! Dhe telefoni do të mbyllet. E unë do ta ngrija përsëri, e përsëri do të më dilte në anën tjetër zoti Çen, e unë do të këmbëngulja kësaj here energjikisht, do të protestoja që ai nuk më linte të flisja me Sui Linin, do t'i thoja se si njeri i shkolluar ai duhej të më kuptonte, duhej të më jepte një rast t'i provoja se s'mund të ekzistonte asnjë ligj që të më pengonte të takoja Sui Linin. Ndoshta në këtë pikë burri do të thyhej, do të ma jepte në telefon, ose ajo do t'ia rrëmbente atij telefonin nga dora. E unë do të dëgjoja zërin e saj: është e kotë, ne s'do të shihemi më. Kam frikë se s'do të shihemi më kurrë!

Kështu më kishte thënë Sui Lini në takimin tonë të fundit, një ditë përpara se të nisesha: Kam frikë se s'do të shihemi më kurrë! Ndodheshim në parkun perandorak dimëror Pei Hai e mbi liqen fluturonin pulëbardha.

Të nesërmen rivendosa lidhjet me miqtë e vjetër. Shumica ishin studentë kthyer me pushime dhe paraditeve zakonisht shkonim në

plazh. Mbrëmjeve mblidheshim te “Kursali”, ku shtynim orët duke pirë ponç portokalli e largoheshim prej andej kur s’mbetej këmbë klienti dhe kamerieret fillonin pastrimin. Nga “Kursali” miqtë e mi përfundonin në një lokal të vogël diku pranë bar “Sahatit”, i vetmi në kryeqytet që rrinte hapur deri në mëngjes. Im atë do të mërzitej po qe se unë do të mungoja në shtëpi tërë natën, për çfarëdo arsyeje qoftë. Por ai do të lëndohej keq nëse do ta gdhija në një lokal që, siç thuhej, ishte lejuar t’u shërbente punëtorëve të natës e ku në të vërtetë mblidheshin vetëm sarhoshë.

Vajta atje një mbrëmje, kur e kalova dozën e ponçit te “Kursali”; jo për të lënduar tim atë. Ndihesha i mërzitur dhe orët në shtëpi më ktheheshin në orë torture. Qëllimi im ishte të zvogëloja në minimum numrin e orëve të qëndrimit në shtëpi. Për këtë duhej të paguaja disa haraçe. Fjala vjen, të përballoja kureshtjen e miqve të mi për Kinën, subjekt tepër i vështirë për mua. Pas tre vjetësh në Kinë, nuk isha më aq naiv sa ç’kisha qenë para se të shkoja atje. Po të filloja t’u flisja për Kinën, kish të ngjarë t’i zhgënjeja. Sepse nuk mund t’i gënjeja. Unë nuk doja as t’i gënjeja, as t’i zhgënjeja miqtë e mi. Doja vetëm të kthehesha përsëri, me çdo kusht, në atë vend për të cilin përgjigjet e mia evazive nuk bindnin njeri. Por unë s’doja të bindja njeri, as për parajsën, as për ferrin kinez. Pozita ime bëhej qesharake kur vinte

puna që miqtë të më pyesnin për temën e tyre të parapëlqyer, marrëdhëniet me vajzat. Vërtet, si ishin vajzat kineze? A dinin të bënin dashuri? Edhe në këtë rast përgjigjet e mia ishin shumë të mangëta. Ata hoqën dorë nga kureshtjet për Kinën, unë mbeta me veten time. Dhe zura të numëroja ditët. Pa dyshuar në asgjë. Deri atë mbrëmje, kur e kalova dozën e ponçit të “Kursali” dhe përfundova me të tjerët të lokali i natës pranë bar “Sahatit”.

Nuk pashë ndonjë shfaqje në kundërshtim me moralin publik. Lokali ndodhej në qendër dhe sarhoshët rrinin urtë. Ata e dinin mirë se, në rastin e rrëmujës më të vogël, ia behte policia. E mund të ndodhte që natën ta kalonin jo në shoqërinë fisnike të gotave, por në ndonjë rajon policie, në ndonjë dhomë izolimi, ku s’përrjashtohej dajaku. Sapo u futa, një mjegullnajë tymi përzier me avuj alkooli më zuri frymën. Do të isha larguar sikur dikush të mos më kishte zënë për krah. Si më tërhoqi, më përqafoi e më pëshpëriti në vesh se po vdiste nga mërzia. Shtoi se s’do të ma falte po të mos bashkohesha me të. Ishte vetëm. Dhe i dehur në atë masë, sa do të qe e pasjellshme ta kundërshtoja. E njihja pak. Studionte në Tiencin s’di për çfarë inxhinierie. As emri i tij s’m’u kujtua. M’u kujtua diçka tjetër: ky tip është madh me mustaqe të dendura, që ngjante si boksier për shkak të hundës së

shtypur, para se të vinte në Kinë kishte qenë me studime në Rusi.

Pa më pyetur ai vajti në banak, mori dy dopio fërnet. Më yshti të pija e m'u duk i mjerë. Përsëri më erdhi keq ta kundërshtoja, tha se qe bërë derr. Po të mos pinte mund t'ia këpuste vetes, e në çastin që kisha mbërritur unë po bëhej gati pikërisht për këtë, t'ia këpuste vetes. Duhet të kesh armë, desha ta ndërprisja për t'i injektuar një dozë humori. S'guxova. Isha aq esëll sa ta kuptoja mërzinë e tij. Në vend të shakasë ktheva dhe unë një gllënjë të madhe fërneti. Kjo shenjë solidariteti u mirëkuptua prej tij, pati më tepër efekt nga ç'do të kishte pasur shakaja ime pa kripë. Ngriti kokën, m'i nguli sytë e megjulluar e qeshi me hidhërim. Pastaj tundi grushtin në ajër, sikur do të godiste dikë në boshllëk. U kam q... nënën të gjithëve, tha ultas dhe m'u afrua. Dy vjet studiova në Sajuz. Më thanë jo, s'do të vazhdosh më atje, u kam q... nënën, për arsye që as e çaj k... Dakord, thashë. Dhe një vit u sorollata rrugëve. Pastaj kujtova se fati më buzëqeshi prapë. Më çuan në Kinë, studiova dhe atje tre vjet. Tani më thonë jo, as në Kinë s'do të shkosh më, për arsye që as e çaj k... fare. Po më shkon jeta student e unë ende s'jam as në qiell as në tokë.

Fjalët e tij më shtinë në sëkëlldi. Instinkti vetëmbrojtës veproi në çast. Vështrova përreth se mos dikush na dëgjonte dhe mendimi i parë ishte të ikja. S'di ç'më mbajti. Ja pamja e

rrënuar e bashkëfolësit, ja kureshtja të mësoja përse këtij mjerani ia ndërprisnin studimet për të dytën herë. Më vajti mendja se mos tipi bënte pjesë në ata që midis studentëve u quajtën “grupi i Parkut Zoologjik”. Në kinezçe, grupi i Tung U Jenit. Nofka u kishte mbetur pas një skandali në mes të Pekinit, verën e kaluar. Një grup studentësh shqiptarë, në stacionin e autobusëve pranë Parkut Zoologjik, ishin përleshur me një turmë kinezësh, shumica, siç u tha, policë të veshur civilë. Për shkak të një vajze. E ngacmuar nga një shqiptar, kinezka paskej thirrur për ndihmë. Shqiptarin e zënë menjëherë me shqelma, gati për ta linçuar, dhe varfanjaku ulërin gjithashtu për ndihmë, e ndihma nuk mungon t’i vijë. Parku Zoologjik shërbente si pikë takimi e mjaft studentëve me vajza kineze. Në sheshin e stacionit paskej plasur grushti, kinezët qenkëshin sultur nga të katër anët mizëri dhe bashkëkombasit e mi paskëshin përfunduar të gjithë sa ishin në qelitë e një burgu të Pekinit, secili më vete, në izolim të plotë. Kinezët këmbëngulën se studentët shqiptarë e kishin mbushur prej kohësh kupën me rrugaçëri dhe pala shqiptare nuk duhej të habitej nëse disa prej tyre do të dëboheshin. Në një rreth të ngushtë miqsh dikush paskej hedhur tezën se gjithçka kishte qenë provokacion i shërbimeve sekrete kineze. Por ky hamendësim shkaktoi frikë dhe në bisedat e përditshme çështja “grupi i Parkut Zoologjik” nuk zihej me gojë.

Si derdhi një lumë sharjesh të ndyra, bashkëfolësi im solli dy dopio të tjera. Ndieja përzierje në stomak. Dhe urgjencën për t'u larguar. Por ai qe vetëm dhe unë s'mund ta lija në atë gjendje. I thashë se gotat e dyta të fërnetit do t'i paguaja unë dhe, si t'i pinim, të shkonim në shtëpi. Ai qeshi. Më përqafoi. E më përplasi turinjve një duhmë të rëndë. Dhe i hodhi poshtë propozimet e mia. Më tha se nuk pranonte absolutisht të fusja dorën në xhep. Sa për të fjetur, plani i tij për sonte ishte shumë më tërheqës nga ç'i propozoja unë. Madje, nëse dëshiroja, mund të shkoja me të, ta kalonim natën me vajza. E hodha poshtë ofertën. Nuk hodha poshtë diçka tjetër, fërnetin. Miqtë me të cilët isha futur në lokal i dhanë fund programit dhe u përpoqën të më mbushnin mendjen të shkoja me ta. Studenti i Tiencinit kundërshtoi. Kundërshtimi i tij m'u duk bindës dhe miqtë e mi, pa e zgjatur, më lanë të qetë. Atëherë, si çova nga fundi dhe gotën e dytë të fërnetit, m'u duk e natyrshme t'i qaja hallin bashkëfolësit, i cili ndërkaq e kishte marrë disi veten. I pëshpërita në vesh nëse atij po ia ngulnin ndoshta ngaqë ishte i grupit të Tung U Jenit.

Tjetri më pa në sy i zhgënjyer. U kam q... nënën atyre të Tung U Jenit, tha me përbuzje. Nuk e ke marrë vesh se asnjëri nga ne s'do të kthehet më në Kinë? Më plasi b... për ata të Tung U Jenit!

U ndjeva i fyer, nuk besova më asnjë fjalë të tij. Ky njeri fliste marrëzira. Për ta provuar këtë isha gati të fusja gishtat në grykë e të nxirrja fërnetin e qerasur prej tij, nëse kjo nuk do të merrej nga të pranishmit si shenjë dehjeje. Por lokali mbetej vazhdimisht i populluar dhe unë s'mund të rrija më atje edhe po të guxoja të fusja gishtat në grykë për të vjellë. Këtë e bëra pak më vonë në shtëpi.

Një shpjegim me prindërit të nesërmen dukej se ishte i pashmangshëm. Hapa sytë i rrethuar nga një heshtje varri. Ndihesha keq, aq sa çdo qortim do të shkaktonte tek unë reagimin e kundërt, mund të bëhej shkak për një skenë. Për fat, në shtëpi ndodhej vetëm im vëlla, i cili mezi po priste të zgjohesha. Tërë turinj ai më njoftoi se, sipas porosive nga lart, sot nuk duhej të shkoja në plazh. Edhe po të shkoja duhej të kthehesha herët, pasdite pritej një vizitë.

Fjalët e tij më ngritën nervat. Gjëja e fundit që më interesonte në ato çaste ishin vizitat e urimit për kthimin tim. Kështu i thashë pak a shumë tim eti, si kisha ndenjur tërë ditën i mbyllur në dhomë dhe ai këmbënguli të paraqitesha, e unë mezi lëviza nga shtrati për të vajtur të drekoja me ta: Më kanë ardhur në majë të hundës vizitat. Im atë nuk tha asnjë fjalë. Vazhdoi të hante, ndërsa unë, ulur përballë tij, zieja në heshtje. Prisja me gjak të ngrirë ç'do

të thoshte, çastin e qortimit për sjelljen time të mbrëmshme. Sigurisht, s'mund t'ia hidhja atij fajin që njihja tipa si studenti i Tiencinit, që piva tërë natën me të, i bëra shoqëri e si shpërblim mora një ankth mbytës. Problemi im qe se s'po i shpëtoja dot këtij ankthi. Do t'i shpëtoja kur t'i mbushja mendjen vetes, apo dikush tjetër të ma mbushte mendjen, se gjithçka kishte thënë ai ishte shpikje e fantazisë së tij të alkoolizuar. Pohimi sipas të cilit asnjëri nga ne nuk do të kthehej më në Kinë, padyshim ishte gënjeshtër. Javët e mbetura të pushimeve do të kalonin shpejt, unë do të kthehesha përsëri në Pekin dhe puna e parë ishte të merrja në telefon Sui Linin. T'i kërkoja të takoheshim menjëherë, atje ku ishim ndarë, në parkun perandorak Pei Hai. Unë e doja. Dhe ajo më donte. Dhe s'kishte arsye të trembeshim. Do t'ia mbushja mendjen të shkonim në mes të sheshit "Tien An Men", të shpalleshim hapur. Ose jo, sheshi "Tien An Men" s'qe fort i përshtatshëm, më mirë të shkonim në Tempullin e Qiellit. Atje, në murin rrethor magjik, do t'i pëshpërisja me buzët pranë tullave të lëmuara e në anën e kundërt, në pikën diametralisht të kundërt me mua, ajo do të më dëgjonte si në telefon, do të më kthente përgjigje. Fjalët e saj do të rrëshqisnin faqes së murit për të ardhur në veshin tim: Nuk është iluzion, nuk është!

Pasdite të mos dalësh nga shtëpia, tha më në fund im atë. Vjen për vizitë ministri me

të shoqen. Të pëlqen apo jo, duhet të jesh i pranishëm!

Ai ishte një burrë i thatë me syze. Unë nuk mund ta dija, dhe nuk mund ta parashikoja, siç nuk mund ta parashikonte dot askush, përfshirë dhe tim atë, se ç'katastrofë do të sillte për të gjithë ne, dua të them për familjen tonë, hija e atij njeriu me pamje aq të rëndomtë. Kur u shfaq në derë, në shoqërinë e një gruaje të bukur, më shtatlartë se ai vetë, mendova se ai njeri, ministër i Punëve Publike, nuk duhej të ishte aq i rëndomtë sa ç'jepte në pamje. Një njeri i rëndomtë s'mund të kishte në krah një grua aq të bukur dhe fizikisht dominante. E më tej, syzet ia rritnin enigmën që fshihnin sytë e ftohtë. Por asgjë nga këto, as gruaja e tij shumë e bukur, as enigma e syve të tij të ftohtë, nuk mund të merreshin si tregues për të paralajmëruar ogurin e zi që sillnin me vete sa herë vinin për vizitë te ne. Përkundrazi, ardhjet e çiftit ministror krijonin në shtëpinë tonë atmosferë euforie.

Në prag të ndonjë vizite të paralajmëruar, nëna kujdesej që gjithçka të shkëlqente nga rregulli dhe pastërtia. Im atë, që frigoriferi të mbushej me sendet e pëlqyera të çiftit, ku spikaste rakia e dëllinjës "Juniper". Sipas ministrit, ajo ishte një xhin i pastër i cilësisë më të lartë, me vlera të jashtëzakonshme po të pihej me masë. Bashkëshortja e tij parapëlqente verën e kuqe "Kallmet". Kjo

gjendej rrallë nëpër dyqane, por im atë bënte çmos ta siguronte përmes të njohurve. Një sasi shishesh me verë “Kallmet”, bashkë me shishet e rakisë “Juniper”, formonin rezervën e paprekshme të familjes sonë, vetëm për çiftin ministror. Kur për ndonjë arsye ata nuk gjenin mundësi të vinin, im atë shqetësohej. E shqetësimin ia kalonte nënës. Të thuash se jeta e tyre pa këto vizita do të zbehej, do të humbiste përmasat. Dhe vrisnin mendjen të gjenin se çfarë mund të mos u kishte pëlqyer atyre gjatë vizitës së fundit. Shqetësimet dilnin të kota. Vinte një çast dhe gruaja e bukur e ministrit merrte në telefon nënën time, e pyeste nëse atë pasdite do të ndodheshin në shtëpi. Retë e zeza të dyshimit shpërndareshin. Nisnin ethet e përgatitjeve për vizitën e re.

Çdo ardhje e tyre nuk mungonte të binte në sy të fqinjëve, të kateve sipër dhe poshtë nesh. Ata e ndiqnin nga dritaret mbërritjen e veturës ministrore dhe shfaqjen e çiftit. Vizita të rangut të tillë në atë pallat ishin privilegj i familjes sonë, pra s’mund të kalonin pa u vënë re. S’jam në gjendje të them nëse fqinjëve u ngjallnin simpati apo smirë. Një gjë është e sigurt: as atyre nuk mund t’u binte në sy ndonjë shenjë ogurzezë, paralajmëruese e katastrofës që do të binte mbi ne për shkak të vizitave të çiftit. Pastaj, katastrofa ishte ende larg. Ishte epoka e euforisë. Unë kisha plot arsye të mos i besoja euforisë. As ngazëllimit të prindërve të mi me

rastin e vizitave të tilla. Nuk ndieja as simpati, as antipati. Dija vetëm se gruaja e ministrit ishte mjaft e bukur dhe pas syzeve ai fshihte ca sy të ftohtë.

Ndjesia e ftohtësisë m'u përftua kur i dhashë dorën për herë të parë duke ia shtrënguar disi në një orvatje nderimi, ndërsa dora e tij u tërhoq menjëherë. Këtij ministri, mendova, ia sjell puna të kryejë çdo ditë numra rekord shtrëngimi duarsh me njerëz turli-lloj, pra me turli-lloj duarsh. Të pastra apo të ndyra, në thelb ato mund të ndaheshin në dy kategori: duar vartësish dhe duar eprorësh. Kur dora e tij u tërhoq menjëherë, pa asnjë reagim ndaj disi-shtrëngimit të dorës sime, u rreka të gjeja në ç'kategori futesha unë dhe përfytyrova se në rastin e kontaktit me duar eprore dora e tij nuk do të mbetej aq e shkujdesur, siç nuk do të mbeteshin të akullt sytë e tij pas mburojës së lenteve. Kjo më çoi në përfundimin se për vizitorin e shquar dora ime hynte në kategorinë vartëse.

Gjatë vizitës së tyre të parë pas ardhjes sime, vizitorët u përqendruan tek unë. Nga dëshira për të lënë mbresa të mira, çka mendoja se do të rregullonte disi imazhin tim të prishur në sytë e prindërve, ia dola t'i vija fytyrës maskën e njeriut që di të çmojë se raste të tilla nuk vijnë çdo ditë. Këtë u përpoq të ma nguliste në kokë dhe vetë ministri, i sapokthyer nga një vizitë në Kinë. Ai zuri t'i tregonte tim eti historinë e

një dreke zyrtare të shtruar për nder të tyre në Pekin, ku u kishin servirur supë me mish gjarpri. Qenë vënë në dijeni për mishin e gjarprit pas përfundimit të drekës, kur pjesët e trupit të kafshës së pështirë ndodheshin në stomakët e të gjithëve dhe një drejtor drejtorie, i neveritur nga ideja e përmbajtjes së elementit gjarpër, në bark, kishte lënë nam me të vjella, pa mundur të vraponte deri në banjë për t'i nxjerrë.

Është një histori e dëgjuar, desha t'i them, të gjithë shqiptarët që vijnë në Kinë e rrëfejnë pikë për pikë kështu. Nuk fola. S'kisha dëshirë të merrja pjesë në bisedë. Vetëm kur ministri zuri t'i shtjellonte tim eti njohuritë e fituara atje për budizmin, pastaj t'i tregonte vizitën në një tempull diku, me pesëqind statuja të ndryshme të Budës, u shkunda. Sikur befas të isha përshkuar nga një rrymë elektrike.

Ministri, sigurisht, s'kishte nga ta dinte se ç'gjendje të sëmure më shkaktonte kur fliste në praninë time për budizëm dhe dishepuj të Budës. Aq më pak të merrte me mend ç'mund të më lidhte mua me një doktrinë të largët, aq jashtë kohe në mjedisin tonë. S'do ta duroja gjatë po të vazhdonte më tej. Më mirë të molloiste historitë e vartësve të tij idiotë me të vjellat e supës së gjarprit. Ndryshe do ta ndërprisja, do t'i thoja të mos më prekte në plagë që dhembnin. Por ministri nuk vuri re gjë. As prindërit. Edhe po të vinin re diçka, ç'do të kuptonin?

Në fund, kur ai e gjykoi se kishte folur mjaft dhe duhej të ngrihej, m'u dha mundësia t'i shtrëngoja prapë dorën, të hetoja epërsinë e saj, bashkë me ftohtësinë e syve pas mburojës së lenteve. Kur i përcollëm poshtë, te shkallët e pallatit, unë pata rastin këtë herë të vëreja buzë trotuarit veturën blu të rangut ministror. Ai duhet të dijë diçka, thashë me vete, i habitur që truri im i ngacmuar ia doli të kryente një arsyetim pragmatik. Dhe, nëse ai di diçka, kjo mund të merret vesh nga im atë. Por atë çast vetura lëvizi, rrëshqiti mbi asfalt dhe shpirti im pragmatik u shua bashkë me largimin e veturës.

Të vërtetën e mora vesh pas disa ditësh. Studenti i Tiencinit nuk më kishte gënjyer, në Kinë s'do të ktheheshin të gjithë. Emri im figuronte në listën e atyre që nuk do të ktheheshin. Këtë e mësova tek pija birrë në "Vollga" me dy djem, njeri i Universitetit të Pekinit, tjetri në Shangai. As ata s'do të ktheheshin më. Ishte fund gushti, asfalti i rrugëve kishte shkrirë nën nxehtësinë ekuatoriale dhe në sallën e lokalit "Vollga", me gjithë ventilatorin e madh mbi krye, na ishin ngjitur këmishat pas trupit. Ai që na e solli lajmin, të freskët si një të vërtetë absolute për shkak të lidhjeve familjare në sfera ku vendoseshin këto punë, këputi ca të shara dhe tha se nuk donte t'ua shihte më surratin

majmunëve të verdhë. Studionte fizikë. Tjetri, ai i Shangait, nuk reagoi. Vazhdoi të pinte dhe shau të nxehtin mbytës. Unë u preva. Më erdhi të rrëmbeja gotën dhe t'ia hidhja birrën turinjeve studentit të fizikës. Në vend të kësaj vazhdova të pija dhe unë qetësisht, derisa e mbarova gotën. Pastaj lashë mbi tryezë paratë për tri birra dhe ika.

Nën diellin ekuatorial, zuri të më shponte si gozhdë në tru mendimi se im atë duhej ta dinte të vërtetën. Diku, përtej monumentit të Skënderbeut, mbeta i hutuar dhe vështrova përreth. Prej disa ditësh, ai ma kishte hedhur fjalën se qëndrimin tim larg shtëpisë edhe për tre vjet të tjera, nuk do ta duronte. Jemi njerëz e me njerëzit gjithçka mund të ndodhë. Ndërsa Kina është tepër larg.

U ktheva në shtëpi. U mbylla në dhomë dhe rashë mbi krevat. Ndjeva realisht humnerën e llahtarshme midis meje dhe Sui Linit.

Duhej të lëvizja, urgjentisht. Para se gjërat të bëheshin fakt i kryer. Listat e studentëve që do të ktheheshin në Kinë dhe atyre që nuk do të ktheheshin qarkullonin klubeve. Disa talleshin, disa shanin nëpër dhëmbë. Të tjerë shpallnin kënaqësinë e shtirë sikur gjoja s'e çanin kokën. Ndërsa mua më mbyti paniku. Heshtja e tim eti, kur Tirana ziente nga thashethemet, më preu çdo shpresë. Im atë nuk ishte aleati im, unë s'mund ta përballoja me të një bisedë për

Sui Linin. Kjo më tmerroi. Siç më tmerronin parullat e shkruara në vende të dukshme për miqësinë e përjetshme shqiptaro-kineze. Të gjitha ishin hipokrizi. Shqiptaro-kinezët dhe kinezo-shqiptarët, në emër të miqësisë së pathyeshme, po më linçonin.

Ju lutem, bëni diçka për mua... Këmbët më kishin çuar pa vetëdije nga zona e pallateve ku banonin një mizëri specialistësh kinezë. Po rrija në një cep të rrugës duke parë grumbujt e tyre tek shkonin e vinin në varg, njëri pas tjetrit, si pata të hutuara. Një koloni e tërë. U flisja atyre, u kërkoja ndonjë shpjegim. Por fytyrat e kinezëve kalonin pranë meje të mumifikuara, të thuash se ndjenin që dikush mund t'i dëgjonte. Nuk jam për t'ju spiunuar, belbëzova. Atë e quajnë Sui Lin, është e racës suaj. Disi ndryshe nga ju vërtet, por jo në pikëpamje racore. As ajo, as unë nuk vuajmë nga komplekse racore. Ajo ndryshon në diçka që shumë prej jush, me kokat plot informacion politik, vështirë ta kuptojnë. Studion për frëngjisht në Institutin e Gjuhëve të Huaja në Pekin. Ndonjëherë kjo botë bëhet e vogël, mbase dikush nga ju e ka parë e mund të më thotë diçka për të, tani që unë po luaj nga trutë. Kinezo-shqiptarët tuaj dhe shqiptaro-kinezët e mi kanë vendosur ndarjen tonë. Sidoqë kokat i keni të mbushura me informacion politik, së paku duhet të jeni në gjendje të kuptoni se

ç'do të thotë të ndash dy njerëz për së gjalli. A më ndihmoni dot të gjej Sui Linin?

Nuk më përgjigjeshin. S'kishin si të më përgjigjeshin. Ata vazhdonin me ngut rrugën, si pata të hutuara. Qe kohë dreke dhe i priste menca. Do të mbushnin stomakët siç nuk i kishin mbushur kurrë në jetën e tyre.

Veturën e çiftit ministror ma zunë sytë kur në rrugë s'dukej këmbë kinezi dhe unë së fundi realizova se prania ime aty ishte dëshmi e një idiotësie. Makina më kaloi pranë dhe ndaloi tutje, buzë trotuarit. Prej andej zbriti bashkëshortja e ministrit, pas saj një vajzë. Gruaja e bukur kishte veshur një fustan të hapur dhe mbante syze dielli. Tjetra, fustan plazhi. Si u puthën, vajza u largua me vrap midis pallateve, gruaja e bukur hipi në veturë. Unë mbeta në trotuar, nën diellin e nxehtë, derisa vetura lëvizti dhe humbi në një kthesë. E mua m'u duk e natyrshme të mendoja se ajo ishte i vetmi njeri që mund të më ndihmonte.

Në shtëpi, në një libër ku im atë mbante numra telefoni konfidencialë, gjeta numrin e ministrit. Shifrat m'u ngulitën në tru, si çelësi i dyerve të universit. Afër mbrëmjes prita çastin kur mund të telefonoja pa u shqetësuar. Po të më dilte ministri do ta mbyllja telefonin. Në rast të kundërt, po të më dilte e shoqja, do të hyja drejt e në temë. Qëllova me fat, telefoni u ngrit dhe një zë gruaje iu përgjigj thirrjes sime. Gruaja mezi e kuptoi përse bëhej fjalë. Unë nuk

i kërkoja ndonjë takim me të shoqin, i kërkoja diçka tjetër. Në veshët e mi mbërriti e qeshura e saj kur i bëra të qartë se i lutesha të më priste ajo vetë dhe me zë të pasigurt ngulmova që ky fakt, pra dëshira ime për ta takuar, të mbetej midis nesh; do të më vinte shumë keq nëse do të merrej vesh nga prindërit e mi.

“Mos u bëj merak”, tha ajo tërë nënkuptim, “s’ka për t’u marrë vesh”. Këto fjalë m’i përsëriti edhe të nesërmen pasdite, në dhomën e pritjes së apartamentit të tyre ministror, në katin e dhjetë të një pallati të sapondërtuar në qendër të kryeqytetit. Ndihesha i çorientuar ja nga përziemërsia turbulluese e gruas, ja nga prania e papritur aty e vajzës së djeshme, një gjimnaziste rreth të gjashtëmbëdhjetave, siç m’u duk. Natyra e bisedës sime ishte konfidenciale, nuk mund të bëhej me një të tretë në mes. Por gjimnazistja s’kishte ndër mend të na linte vetëm. Më acaronte, më nxiste dëshirën për t’i dhënë një shuplakë. Këtë dëshirë nuk ma zbuti as e qeshura e saj kur gruaja e ministrit ndërhyri të na njihte dhe e sigurt në vetvete shqiptoi emrin Eva e unë, nga ana ime, nxora nëpër dhëmbë fjalën njërrrokëshe Genc, e u detyrova ta përsërisja aty për aty me zë më të lartë, në mënyrë më të artikuluar, që të bëhej i kapshëm për veshët e gjimnazistes.

Atë ditë unë s’kisha ndonjë arsye të përfytyroja se ajo vajzë, me emrin e gruas së parë mëkatore të botës, do të bëhej bashkëshortja

ime. Po të qe kështu, domethënë po të kisha pasur edhe parandjenjën më të vogël, do t'i isha lutur me mirësjellje të largohej, të shihte punën e vet, të priste çastin kur trajektoret tona të puqeshin. Dhe nëse emri i saj parashihte ndonjë mëkat, t'u ruhej mëkateve. Unë nuk quhesha Adam, Eva ime nuk gjendej aty. Ajo ndodhej larg e mëkatari në këtë rast isha unë, përderisa rrija dhe vështroja sytë kafshues të vajzës. Gruaja e bukur e ministrit më bëri të ditur se ajo ishte mbesë e saj. Doemos, mendova, edhe ajo do të martohet me ndonjë ministër. Kjo profeci, mjerisht për të, nuk do të realizohej. Jo vetëm ngaqë mua nuk më shkonte nëpër mend se mund të bëhesha ministër. Ndoshta i shkonte gjimnazistes. Ndoshta tezes së saj. Ndërsa unë nuk e zotëroja qetësinë e duhur për të bërë supozime, fjala vjen, të hamendësoja se vajza me emrin e femrës së parë mëkatare të botës nuk ndodhej atje rastësisht. Aq më pak të krijoja një lidhje midis pranisë së saj, vajtjes sime dhe ndonjë projekti të ardhshëm ministror për mua. Në ato çaste dëshira ime e vetme ishte të largohej vajza, të mbetesh me gruan e bukur, t'i lutesha të ndërhynte te bashkëshorti i fuqishëm, ky të bënte diçka për mua e unë të kthehesha përsëri në atë vend të largët, ku më priste një dhimbje.

Gruas së ministrit nuk ia zura me gojë emrin e Sui Linit. Vetëm iu luta të më ndihmonte të kthehesha në Kinë. Ajo ma kuptoi hallin,